



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në :

“Gazetari dhe Komunikim”

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Blerina Gjerazi
2. Prof.Asoc.Dr. Ilda Kashami

Shtator/ 2025

Tabela përmbledhëse për programin e studimit Bachelor në:

“Gazetari dhe Komunikim”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM 328 datë 30.07.1992
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër Nr. 414 datë 14.07.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr 176 datë 14.06.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike/ 6 simestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 i kornizës kombëtare
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 18 PAE/2 PAK 2023-2024 18 PAE/2 PAK 2024-2025 18 PAE/2 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023, 81 studentë 2023-2024, 61 studentë. 2024-2025 47 studentë.
19	Komente / të tjera:	Njësia kryesore ku ofrohet ky program studimi është Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë.

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim,” i ofruar nga Departamenti i Komunikimit dhe Gazetarisë në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës, është riorganizuar me Urdhër Nr. 414, datë 14.07.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Ky program ka një ngarkesë mësimore prej 180 kredite (ECTS) dhe zgjat tre vite akademike, duke ofruar një balancim të mirë midis njohurive teorike dhe aftësive praktike në fushën e gazetarisë dhe komunikimit.

Programi kontribuon ndjeshëm në përgatitjen e profesionistëve të rinj për tregun e punës mediatik dhe institucional, duke përbushur një nevojë të rëndësishme për shoqërinë shqiptare dhe zhvillimin demokratik të saj. Ai ka rëndësi të veçantë për interesin kombëtar, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së informacionit dhe etikës profesionale në media.

Gjithashtu, ky program krijon bazën e duhur për ndjekjen e cikleve të mëtejshme të studimeve master dhe doktoraturë, duke nxitur zhvillimin akademik dhe shkencor në këtë fushë. Mësimdhënia zhvillohet në kushte bashkëkohore, me infrastrukturë të përmirësuar dhe mjete didaktike moderne.

Një vlerë e shtuar e këtij programi është stafi akademik i kualifikuar, me përvojë në fushën e gazetarisë, komunikimit dhe kërkimit shkencor. Qëllimi kryesor i programit është formimi i specialistëve të aftë për të analizuar, prodhuar dhe transmetuar informacion me integritet profesional dhe etik, në përputhje me sfidat bashkëkohore të komunikimit në shoqërinë demokratike dhe mediatike.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit “Bachelor në Gazetari dhe Komunikim” u zhvillua në përputhje me standardet e cilësisë në arsimin e lartë dhe metodologjinë e përcaktuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Qëllimi kryesor i këtij procesi ishte të ofronte një analizë gjithëpërfshirëse dhe objektive mbi përmbushjen e standardeve akademike, cilësinë e mësimdhënies, rezultatet e të nxëniet, si dhe përputhshmërinë e programit me zhvillimet bashkëkohore dhe kërkesat e tregut të punës.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit, planet mësimore, të dhënat mbi stafin akademik, statistikën e punësimit të studentëve, rezultatet e arritura, si dhe burimet infrastrukturore.

Në datat 7–8 prill 2025, GVJ zhvilloi një vizitë në ambientet e institucionit, ku u organizuan takime me drejtues të fakultetit dhe departamentit, staf pedagogjik, studentë, si dhe përfaqësues të degës mësimore dhe strukturave të tjera të lidhura me procesin e akreditimit. Këto takime shërbyen për të thelluar vlerësimin dhe për të verifikuar në praktikë informacionin e përfshirë në dokumentacionin përkatës, duke marrë në konsideratë të dhënat e evidentuara në sistemin AMS të ASCAL.

Diskutimet u zhvilluan në një atmosferë bashkëpunuese dhe transparente, ku të gjitha palët shfaqën një qasje pozitive dhe të hapur ndaj sugjerimeve që kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe funksionimit të përgjithshëm të programit. Vlerësimi u mirëprit si një mundësi për reflektim dhe zhvillim të mëtejshëm në përputhje me praktikën më të mira evropiane në arsimin e lartë.

Parimet kryesore të punës gjatë procesit të Vlerësimit të Jashtëm përfshijnë:

- Objektivitetin, duke u bazuar në fakte dhe të dhëna konkrete.
- Transparencën, përmes një procesi dhe komunikimi të hapur me institucionin.
- Bashkëpunimin, përmes diskutimeve dhe takimeve në frymë respekti dhe dialogu.
- Konfidencialitetin, duke trajtuar me kujdes dhe siguri informacionet e marra.
- Qasjen gjithëpërfshirëse, duke marrë parasysh të gjitha aspektet dhe perspektivat e programit.
- Përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm në datë 03.07.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr Prot 129/8, datë 03.07.2025. Institucioni njofton për komentet në ASCAL më datë 10.07.2025, nëpërmjet shkresës me Nr Prot -, datë 10.07.2025. IAL s ka komente, drafti merr formën e raportit përfundimtar.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” i ofruar nga Universiteti i Tiranës, është në përputhje me interesat kombëtare dhe respekton parimet themelore të etikës akademike dhe profesionale. Përmbajtja kurrikulare synon ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore dhe identitetit kombëtar, përmes lëndëve që trajtojnë historinë e medias shqiptare, rolin e komunikimit në shoqërinë demokratike, si dhe aspektet etike dhe juridike të gazetarisë. Programi kontribuon gjithashtu në edukimin qytetar dhe në formimin e profesionistëve që reflektojnë përgjegjësi sociale dhe ndjeshmëri ndaj çështjeve kombëtare. <i>E. 1.1. Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” është në përputhje me misionin institucional të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës, i cili synon formimin e specialistëve të aftë në fushat humanistike dhe shoqërore. Hartimi i programit reflekton objektivat akademike dhe shkencore të institucionit, duke ofruar një përmbajtje të balancuar ndërmjet teorisë dhe praktikës në fushën e medias dhe komunikimit. Lëndët përputhen me fushën e veprimtarisë së institucionit dhe kontribuojnë në zhvillimin e mendimit kritik, kompetencave komunikuese dhe përgatitjes për tregun e punës në përputhje me nevojat e shoqërisë shqiptare. <i>E. 1.1. Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.12. Studim Tregu- Media in Fokus</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me dokumentet themelore të Universitetit të Tiranës, përfshirë Statutin, Rregulloren e Përgjithshme dhe strategjinë afatmesme të zhvillimit akademik. Programi respekton drejtimet kryesore akademike të institucionit dhe mbështet objektivat strategjike për ofrimin e arsimit cilësor, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar në fushën e

	komunikimit publik dhe medias. Ai reflekton qartë përshtatjen me strukturën akademike të institucionit dhe është në linjë me zhvillimet bashkëkohore të fushës si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. <i>E. 1.2. Strategjia e Zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i> <i>E. 1.1. Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvorje, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti i Tiranës, përmes Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit demonstroi përvorje të konsoliduar në ofrimin e programeve të studimit në këtë fushë. Staf i akademik përbëhet nga pedagogë me tituj shkencorë dhe përvorje të gjatë akademike dhe profesionale në fushën e medias, komunikimit publik dhe gazetarisë. Ky aspekt garanton cilësi në procesin e mësimdhënies dhe mentorimit të studentëve. Departamenti disponon burime të rëndësishme materiale dhe didaktike për zhvillimin e programit, përfshirë laboratorë të gazetarisë, ambiente për praktikë dhe akses në literaturë të specializuar. Gjithashtu, lidhjet me median dhe institucionet publike/private për ofrimin e praktikave profesionale kontribuojnë në përgatitjen praktike të studentëve. <i>E. 1.15. Lista e PAE</i> <i>E. 1.12. Studim Tregu- Media in Fokus</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim" është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse, Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, i cili funksionon brenda Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Departamenti ka një profil të qartë akademik dhe kërkimor në këtë fushë, me staf të specializuar dhe me aktivitete të dokumentuara në fushën e gazetarisë, komunikimit mediatic dhe studimeve të opinionit publik. Programi reflekton përmbajtje që buron nga kjo përvorje kërkimore dhe është i ndërtuar mbi baza akademike të qëndrueshme, duke respektuar standardet e fushës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>E. 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Konkluzione	Bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur, vizitës në institucion dhe intervistave me aktorët përkatës, konstatohet se programi i studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim" ofruar nga Universiteti i Tiranës përmbush në mënyrë të përgjithshme dhe cilësore kriteret e vlerësimit sipas standardeve të përcaktuara nga ASCAL. Programi përputhet me misionin, strategjinë dhe fushën

	<i>akademike të institucionit, reflekton vlerat akademike dhe kulturore kombëtare, si dhe kontribuon në edukimin qytetar dhe etik profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Institucioni demonstroi një strukturë funksionale dhe të ndarë qartë në përgjegjësi për hartimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e programit të studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim". Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, si njësi bazë përgjegjëse bashkëpunon ngushtë me njësitë e tjera të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë dhe me strukturat e nivelit qendror të Universitetit të Tiranës. Ekzistojnë procedura të qarta për ndarjen e detyrave ndërmjet stafit akademik dhe administrativ, si dhe mekanizma të brendshëm për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, përmirësimit të programeve dhe analizën e ecurisë së punës. Takimet periodike të departamentit, komisionet për rishikimin e kurrikulës, si dhe raportet vjetore të vetëvlerësimit tregojnë angazhim për përmirësim të vazhdueshëm. Ky bashkëpunim i brendshëm institucional ndihmon në mbarëvajtjen efektive të programit dhe garanton ndarjen e drejtë të përgjegjësi, duke mbështetur një kulturë akademike bashkëpunuese dhe transparente. <i>E. 6.1. Rregullore e Sigurimit të Cilësisë në UT</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Universiteti i Tiranës dhe departamenti përkatës i Gazetarisë dhe Komunikimit kanë krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione akademike homologe, si brenda vendit ashtu edhe ndërkombëtarisht. Këto lidhje i mundësojnë studentëve dhe stafit akademik akses në eksperiencë dhe praktikë më të avancuar, përmes programeve të shkëmbimit, seminareve dhe projekteve të përbashkëta. Gjithashtu, bashkëpunimi me aktorë të biznesit dhe median vendase dhe ndërkombëtare është i dukshëm, duke u ofruar studentëve mundësi për praktikë profesionale, trainime dhe pjesëmarrje në projekte reale mediatike. Këto marrëdhënie përforcojnë lidhjen mes formimit akademik dhe tregut të punës, duke rritur cilësinë dhe relevancën e programit në përmbushjen e objektivave të tij mësimore dhe formuese.
	<i>E. 1.9. Marrëveshjet e Bashkëpunimit</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan	Institucioni ka ngritur dhe mirëmban marrëveshje të posaçme me institucione dhe subjekte të ndryshme brenda fushës së gazetarisë dhe komunikimit, duke përfshirë media lokale dhe kombëtare, agjensi

	<i>partnerë të ndryshëm janë instrument i rëndësishëm për zbatimin e praktikave dhe stazheve, duke kontribuar në lidhjen e teorisë me praktikën.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit “Bachelor në Gazetari dhe Komunikim” është i strukturuar në mënyrë të qartë dhe transparente, duke u ndarë në lëndë dhe module që përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet kombëtare. Struktura e programit respekton plotësisht kërkesat e legjislacionit vendas në fuqi, si dhe është në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Çdo lëndë ka përcaktuar qartë objektivat, përmbajtjen dhe kreditet, duke pasqyruar balancim në totalin e krediteve për ciklin e parë të studimit. Kjo formë organizimi lehtëson njohjen dhe transferimin e krediteve në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, duke kontribuar në ndërkombëtarizimin dhe fleksibilitetin e rrugës akademike të studentëve. Struktura e programit është hartuar në mënyrë që të sigurojë zhvillimin progresiv të kompetencave, nga njohuritë bazë te aftësitë profesionale specifike të fushës së gazetarisë dhe komunikimit. <i>E. 2.6. Propozim për riorganizimin e programit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”</i> <i>E. 1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”</i> <i>E. 1.1. Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të	Programi i studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” synon të ofrojë një formim të thelluar dhe të specializuar në fushën e

marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	komunikimi, institucione publike dhe organizata të tjera relevante. Këto marrëveshje mundësojnë realizimin e praktikave profesionale dhe stazheve për studentët e programit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”, duke siguruar një lidhje të drejtpërdrejtë midis teorisë dhe praktikës profesionale. Përmes këtyre bashkëpunimeve, studentët kanë mundësi të përvetësojnë aftësi praktike në mjedise reale pune, duke u përgatitur për sfidat e tregut të punës dhe duke rritur potencialin e tyre profesional. Institucioni monitoron dhe vlerëson vazhdimisht këto marrëdhënie bashkëpunimi për të garantuar cilësinë dhe përfitimet e praktikave për studentët. https://www.reporterinvestativ.al E. 1.9. Marrëveshjet e Bashkëpunimit
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia përgjegjëse për programin Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” në Universitetin e Tiranës ndjek një praktikë të rregullt për hartimin e raporteve analitike lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione, organizata dhe subjekte të tjera për realizimin e programit. Këto raporte përmbajnë analizë të përfitimeve që rrjedhin nga këto bashkëpunime, si për studentët ashtu edhe për institucionin në përgjithësi, duke evidentuar ndikimin në cilësinë e mësimdhënies, përmirësimit e përmbajtjes kurrikulare dhe zgjerimin e mundësive për praktika profesionale. Procesi i raportimit periodik kontribuon në monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të bashkëpunimeve, duke mundësuar marrjen e masave për përmirësime të mëtejshme dhe rritjen e transparencës në menaxhimin e programit. Kjo praktikë reflekton një qasje sistematike dhe të përkushtuar ndaj cilësisë akademike dhe zhvillimit institucional. E. 1.16. Kanalet televizive shqiptare në rrjetet sociale: Vështrim analitik, gjetje përfundime, DGK-AMA, Tiranë 2023, ISBN: 9789928064233. E. 1.7. Raporti i analizës vjetore në Departament, Viti akademik 2022-2023 E. 1.17. Edukimi mediatik në Shqipëri, DGK-KAS, Tiranë 2023, ISBN 978-9928-363-36-7
Konkluzione	<i>Pas analizës së dokumentacionit dhe praktikave të zbatuara nga njësia përgjegjëse për programin Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” në Universitetin e Tiranës, konkludohet se institucioni ka krijuar dhe mban një strukturë funksionale dhe efikase për menaxhimin e programit, me ndarje të qartë përgjegjësisë dhe bashkëpunim të mirë ndërmjet njësive akademike dhe administrative. Bashkëpunimet me institucione homologe, aktorë të biznesit dhe institucione të tjera relevante janë të zhvilluara dhe ofrojnë mundësi të vlefshme për studentët, veçanërisht në fushën e praktikave profesionale. Marrëveshjet e nënshkruara me</i>

veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	komunikimit dhe medias, duke përgatitur studentët për një gamë të gjerë profesionesh dhe roleve brenda sektorit të gazetarisë, komunikimit publik, mediave digjitale dhe fushave të lidhura. Nëpërmjet një qasjeje të balancuar teoriko-praktike, programi zhvillon njohuri të avancuara mbi teoritë dhe parimet akademike të fushës, duke inkurajuar një kuptim kritik dhe analitik të tyre. Për më tepër, ai forcon aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për adresimin e sfidave që karakterizojnë mjedisin mediatik dhe komunikimin bashkëkohor. Ky fokus i programit kontribuon në përgatitjen e profesionistëve të aftë të zgjidhin probleme reale në mënyrë inovative dhe efektive, duke e bërë atë të përshtatshëm për kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>E. 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim".</i> <i>E. 1.8. a. Plan i mësimor / Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim" paraqet një strukturë të qartë dhe të mirëorganizuar të veprimtarive formuese, ku lëndët dhe modulet janë të grupuara sipas kategorive të përcaktuara në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet akademike. Për secilën kategori, ngarkesa mësimore është përcaktuar dhe e ndarë në kredite ECTS, duke siguruar balancë midis njohurive teorike, praktikës profesionale dhe zhvillimit të aftësive të përgjithshme. Lëndët janë të ndara: • Lëndë Bazë (A): 33 ECTS ≈ 18% • Lëndë Karakterizuese (B): 94 ECTS ≈ 52% • Lëndë Ndërdisciplinare/Integruese (C): 28 ECTS ≈ 15% • Lëndë Plotësuese/Formuese (D): 17 ECTS ≈ 10% • Punim diplome/provim përfundimtar: 8 ECTS ≈ 4% Kjo ndarje e kategorizuar e lëndëve lehtëson orientimin e studentëve gjatë studimeve, si dhe njohjen dhe vlerësimin e kompetencave të fituara. Struktura është në harmoni me sistemin e krediteve, duke mundësuar mobilitet akademik dhe njohje të rezultateve në nivele dhe institucione të ndryshme. Përmirësime të mëtejshme kryhen si rezultat i rishikimit periodik të përputhshmërisë së ngarkesës së krediteve me përmbajtjen dhe kërkesat e tregut profesional, duke garantuar fleksibilitet dhe adaptim ndaj ndryshimeve në fushën e gazetarisë dhe komunikimit. <i>E. 1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>




Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” përcakton qartë ngarkesën në kredite ECTS për realizimin e praktikës profesionale si dhe për detyrimet përmbyllëse, duke u siguruar që këto komponentë të jenë pjesë integrale e kurrikulës dhe të kenë peshën e duhur në strukturën e përgjithshme të programit. Ngarkesa në kredite për praktikat profesionale është përcaktuar në mënyrë që studentët të kenë mundësi të fitojnë përvojë praktike të nevojshme në mjedise reale pune, ndërsa detyrimet përmbyllëse (p.sh., projekti i diplomës apo provimi përfundimtar) përfaqësojnë fazën kulmore të zhvillimit të kompetencave dhe njohurive të fituara gjatë ciklit të studimit. Kjo qasje kontribuon në sigurimin e një bilanci midis aspektit teorik dhe praktik të formimit dhe përgatit studentët në mënyrë të mirë për tregun e punës dhe sfidat profesionale. <i>E. 1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”.</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Institucioni respekton në mënyrë rigoroz legjislacionin e arsimit të lartë dhe udhëzimet e Ministrisë për Arsimin dhe Sportin në lidhje me organizimin e studimeve, procesin e pranimi të studentëve dhe financimin e programeve të studimit. Forma e organizimit të ciklit bachelor në Gazetari dhe Komunikim është në përputhje me standardet dhe kriteret ligjore. Financimi i programit realizohet sipas normave të përcaktuara, duke garantuar burime të mjaftueshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe mbështetjen e studentëve gjatë studimeve. Institucioni merr parasysh specifikat e statusit të tij për të përshtatur mekanizmat e financimit dhe organizimit në përputhje me kërkesat ligjore dhe të mjedisit akademik. <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”.</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Ky kriter realizohet plotësisht nga institucioni. Programi i studimit ka përmbajtje të ngjashme me programe të tjera që organizohen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si në ciklin e studimit, kurrikulën mësimore ashtu edhe në objektivat formues dhe temat kryesore të programeve. Kjo ngjashmëri garanton standarde të barabarta të cilësisë dhe përmbushjen e kërkesave minimale për studentët në të gjitha degët apo njësitë ku ofrohen këto programe. Për më tepër, mundëson lehtësimin e njohjes së kredive dhe mobilitetin e studentëve brenda institucioneve të ndryshme, duke siguruar uniformitet në arsimimin akademik.

	<i>E. 1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim" është i kodifikuar në përputhje me klasifikimet zyrtare të fushave të studimit, të publikuara nga Ministria për Arsimin dhe Sportin. Kodi i programit 63BA0329S reflekton saktë fushën akademike dhe lehtëson identifikimin dhe njohjen institucionale të tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjithashtu, lëndët dhe modulet e programit janë kodifikuar në mënyrë të qartë duke siguruar lehtësi në menaxhimin akademik, si dhe në administrimin e krediteve dhe vlerësimin e studentëve. Ky sistem i kodifikimit mbështet organizimin e procesit mësimor, duke mundësuar integrimin e programit në sistemin evropian të arsimit të lartë dhe promovimin e mobilitetit akademik. <i>E. 1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Institucioni ka mundësi dhe mund të planifikojë në të ardhmen bashkëpunimin me institucione të tjera të arsimit të lartë, si vendase ashtu edhe të huaja për të ofruar programe studimi të përbashkëta në përputhje me legjislacionin në fuqi. Aktualisht, ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës.			
Konkluzione	<i>Pas vlerësimit të programit të studimit në përputhje me kriteret e përcaktuara, konkludohet se struktura dhe organizimi i programit janë të qarta dhe të harmonizuara me legjislacionin vendas dhe sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), duke siguruar një ndarje të balancuar të lëndëve dhe moduleve sipas kategorive të përcaktuara. Qëllimet dhe përmbajtja e programit janë të orientuara drejt formimit të njohurive dhe kompetencave të avancuara, me fokus në zhvillimin e aftësive kritike dhe zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e gazetarisë dhe komunikimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë si njësia kryesore, ka në përbërje gjashtë departamente akademike, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë fushash të studimit dhe kërkimit shkencor. Këto janë:

përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	▪ Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore ▪ Departamenti i Gazetarisë dhe i Komunikimit ▪ Departamenti i Gjeografisë ▪ Departamenti i Historisë ▪ Departamenti i Letërsisë ▪ Departamenti i Gjuhësisë Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë dhe Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në Gazetari dhe Komunikim përbushin në mënyrë të plotë detyrimet ligjore në fuqi që lidhen me organizimin dhe strukturën akademike të programit. Stafet akademike janë të kualifikuara, të mjaftueshme në numër dhe me kompetenca të përshtatshme për realizimin e programeve mësimore dhe kërkimore. Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit gjatë tre viteve të fundit ka një pasur një qëndrueshmëri në numrin e staf akademik efektiv me një numër prej 17 anëtarësh, prej të cilëve 2 me titullin akademik “Profesor”, 7 me titullin akademik “Profesor i Asociuar”, 6 me gradën shkencore “Doktor i Shkencave”, 2 asistentë lektorë me nivel “Master i Shkencave” . Njësia menaxhon në mënyrë efektive procesin e vlerësimit dhe akreditimit të programit, duke siguruar përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë. <i>E. 1.1. Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.15. Lista e PAE</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë si njësi kryesore, si dhe Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në Gazetari dhe Komunikim përbushin detyrimet ligjore që lidhen me angazhimin e personelit ndihmës akademik/ administrativ. Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës akademik. <i>E. 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit ka përcaktuar koordinatorin e programit të studimit sikurse dokumentohet nëpërmjet evidencës E.2.3. Koordinatorin luan një rol të rëndësishëm për mbarrëvajtjen e programit të studimit. <i>E.2.3. Urdhër për emërimin e koordinitorit të programit të studimit</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”</i>

Konkluzione	Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara, konkludohet se ky kriter përmbushet plotësisht. Njësia kryesore dhe njësia bazë e programit të studimit organizon dhe strukturon programin në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar staf akademik të kualifikuar dhe të mjaftueshëm për realizimin e mësimdhënies dhe kërkimit, si dhe përmbudh detyrimet e tjera ligjore dhe akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë “Gazetari dhe Komunikim” disponon në mënyrë të plotë dhe të përditësuar të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Këto të dhëna përfshijnë kurrikulën mësimore, planin mësimor, syllabuset dhe përshkrimet e lëndëve, ngarkesën në kredite dhe objektivat formuese të programit të studimit. <i>E. 1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit përmban një plan mësimor të detajuar dhe të strukturuar qartë, ku janë të përfshira të gjitha elementet e nevojshme të organizimit të procesit mësimor. Në planin mësimor paraqitet ndarja e lëndëve/moduleve në semestra, duke reflektuar rrjedhshmërinë logjike të njohurive dhe aftësive që studentët duhet të përvetësojnë. Gjithashtu, ngarkesa mësimore për secilën lëndë është specifikuar me saktësi në kredite dhe orë, duke përfshirë ndarjen midis orëve në auditor dhe orëve jashtë auditorit (përgatitje individuale, detyra praktike, punë në grup). <i>Evidenca 1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit përmban informacion të plotë dhe të qartë lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin e studentëve, procesin e transferimit nga programe apo institucione të tjera, si dhe ekuivalentimin e krediteve dhe lëndëve të kryera më parë. Ky informacion është i strukturuar në mënyrë të lehtë për t’u kuptuar dhe i disponueshëm për studentët. Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit si njësia përgjegjëse për programin tregon kujdes për

	përditësimin dhe komunikimin e rregullt të këtyre kritereve, duke i bërë ato pjesë integrale të dokumentacionit të programit dhe platformës informative për studentët <i>Evidenca 1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim".</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit përmban informacion të plotë dhe të strukturuar në mënyrë të detajuar për çdo lëndë, duke përfshirë syllabuset përkatëse që përshkruajnë përmbajtjen, qëllimet, objektivat dhe metodat e mësimdhënies. Përveç orëve të auditorit, syllabuset përfshijnë edhe detajet për praktikën, seminarin, orët e laboratorit dhe komponentët e tjerë formues të programit, duke garantuar një pamje të plotë të procesit mësimor. Nga verifikimi i dokumentacionit paraprak të ngarkuar në sistem, u vu re se syllabuset kishin disa parregullsi. Pas vizitës në institucion, u kërkuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm harmonizimi me formatin e miratuar sipas Vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, i cili u reflektua nga institucioni. <i>E. 2.1. Syllabuset e lëndëve</i> <i>E. 1.8. a. Plani mësimor / Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Programi i studimit karakterizohet nga një proces i qëndrueshëm dhe i strukturuar për përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes akademike. Çdo vit akademik, njësi përgjegjëse shqyrton dhe miraton ndryshimet e nevojshme në program, duke u bazuar në feedback-un e studentëve, zhvillimet shkencore dhe nevojat e tregut të punës. Ky proces përfshin dokumentimin dhe arkivimin sistematik të versioneve të ndryshuara të programit, duke siguruar kështu gjurmueshmëri në historikun e evoluimit të programit. <i>E. 2.11. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit.</i> <i>E. 2.1. Syllabuset e lëndëve</i>			
Konkluzione	<i>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar dhe vizitës në IAL, GVJ vlerëson se njësi përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë në Gazetari dhe Komunikim disponon informacion të plotë dhe të organizuar për strukturën, përmbajtjen dhe organizimin e programit. Në përgjithësi, programi i studimit përmbush standardet e kërkuara për një edukim cilësor dhe të përshtatshëm me nevojat e studentëve dhe shoqërisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i programit të studimit është i qartë dhe i përshtatshëm, duke reflektuar në mënyrë të qartë përmbajtjen dhe fushën akademike që mbulon. Përmbajtja e veprimtarive mësimore, duke përfshirë lëndët dhe praktikën, është e strukturuar në mënyrë të tillë që të mundësojë thellimin progresiv të njohurive dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme. Shpërndarja e lëndëve dhe praktikave është e ekuilibruar dhe i përgjigjet objektivave formuese, duke siguruar një balancë mes teorisë dhe praktikës, që nxit përgatitjen efektive për studime të mëtejshme dhe për futjen e suksesshme në tregun e punës. Programi harmonizohet me Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, duke garantuar që rezultatet e të nxënit dhe kompetencat e fituara të jenë në përputhje me kërkesat akademike dhe profesionale aktuale. <i>E. 1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Struktura e programit të studimit, duke përfshirë ndarjen e lëndëve/modulëve në vite dhe semestre është e organizuar në mënyrë të qartë. Kjo shpërndarje i mundëson studentëve të përvetësojnë gradualisht njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, duke u përshtatur me objektivat formuese të programit. Vlerësimi i ngarkesës së punës në kredite ECTS dhe orët mësimore janë të balancuara dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet evropiane, Kjo strukturë mbështet arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit, duke mundësuar një proces mësimor të efektshëm dhe të matshëm. <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit të studimit është e përshtatur mirë me profilin specifik të tij, duke siguruar një balancë të drejtë midis komponentëve teorikë dhe atyre praktikë. Raporti teori-praktikë kontribuon në zhvillimin e aftësive të nevojshme profesionale dhe në thellimin e njohurive konceptuale, duke përgatitur studentët për sfidat e tregut të punës dhe për kërkesat akademike.

	Gjithashtu, përmbajtja dhe struktura e programit janë të harmonizuara dhe të krahasueshme me programe të ngjashme në institucione ndërkombëtare, duke reflektuar standardet dhe praktikat më të mira globale në fushën e studimit. <i>E. 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja e veprimtarive formuese brenda programit është e strukturuar në mënyrë të tillë që siguron një balancë efektive mes formimit teorik dhe praktik. Ky raport i qëndrueshëm kontribuon në arritjen e objektivave formuese të programit, duke garantuar që studentët të zhvillojnë kompetencat e nevojshme në aspektet konceptuale dhe ato praktike. Një fokus i veçantë vihet te mundësitë për transferim studimesh dhe mobilitet akademik, duke e bërë programin të përshtatshëm me kërkesat e Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve. Praktikrat dhe veprimtaritë jashtë auditorit forcojnë aftësitë profesionale dhe përgatitjen për punësim, duke kontribuar në një formim të plotë dhe të përshtatshëm me kërkesat e shoqërisë dhe ekonomisë. <i>E. 1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset e lëndëve dhe moduleve të programit përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke reflektuar zhvillimet e fundit në fushën e gazetarisë dhe komunikimit dhe kërkesat aktuale të tregut të punës. Përzgjedhja e literaturës bazë dhe ndihmëse përfshin botime relevante, duke siguruar një bazë solide akademike dhe burime të freskëta për studentët. Megjithatë, institucioni duhet të mbajë në konsideratë përditësimin e disa syllabuse të programeve lëndore me literaturën e viteve të fundit. Gjatë vizitës stafi u shpreh se për disa lëndë bazë literatura edhe pse nuk është e viteve të fundit, është literatura klasike që lidhet me fushën e komunikimit, si për shembull Teoritë e Komunikimit Masiv. <i>E. 1.12. Studim Tregu- Media in Fokus</i> <i>E. 5.1. Analiza e Departamentit për objektivat formues të programit të studimit</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit është e strukturuar në mënyrë që të sigurojë përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, të cilat përputhen me objektivat formuese dhe kërkesat e tregut të punës. Kombinimi i njohurive teorike me praktikrat profesionale dhe aktivitetet formuese siguron që studentët të jenë të përgatitur për të përballuar sfidat komplekse të fushës së tyre, duke i mundësuar ata të kontribuojnë në mënyrë efektive në mjedisin profesional mediatik dhe shoqëror.

	<i>E. 1.8. a. Plani mësimor / Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit është hartuar në mënyrë që të lehtësojë vijimin e studimeve në ciklet e mëtejshme akademike, duke siguruar njohuri dhe kompetenca themelore dhe të avancuara të nevojshme në fushën e gazetarisë dhe komunikimit. Njëkohësisht, programi është orientuar drejt kërkesave dhe pritshmërive të tregut të punës, duke përgatitur studentët për integrim të suksesshëm në sektorët profesionalë mediatik.			
	<i>E. 1.8. a. Plani mësimor / Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidenton se ky kriter përmbushet plotësisht. Struktura dhe organizimi i programit janë të qarta, të balancuara dhe në përputhje me objektivat formuese, duke siguruar një shpërndarje të drejtë midis lëndëve teorike dhe atyre praktike që i përgjigjen profilin të programit dhe standardeve ndërkombëtare. Programi është konkurrues në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke respektuar standardet e arsimit të lartë dhe duke ofruar një kornizë të mirë për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Programi i studimit pasqyron një përpjekje të qëndrueshme për të ruajtur përputhshmërinë me kërkesat në zhvillim të tregut të punës. Njësitë përgjegjëse për hartimin dhe përmirësimin e programit demonstrojnë një qasje të hapur dhe të strukturuar ndaj konsultimit me aktorët e jashtëm: përfaqësues të institucioneve partnere, të diplomuarit dhe përfaqësues të sektorit privat dhe publik. Përdorimi i informacionit të mbledhur nga këto burime reflektohet në përmbajtjen e përditësuar të programit dhe në orientimin praktik të disa moduleve, duke ndihmuar në përafrimin e arsimit universitar me realitetin profesional. Kjo përfshin integrimin e kompetencave të reja të kërkuara në fusha të caktuara të komunikimit dhe gazetarisë. <i>E. 2.12. Procesverbale të takimeve për përpilimin e programit në retreat-e.</i>

	E. 1.12. Studim Tregu- Media in Fokus			
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni promovon qasjen e duhur në drejtim të përfshirjes së studentëve dhe të diplomuarve në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Përmes strukturave studentore, pyetësorëve të rregullt, tryezave të hapura dhe mbledhjeve në departament, studentët marrin pjesë aktive në diskutimet që lidhen me përmbajtjen dhe cilësinë e programit. Gjithashtu, mbajtja e kontakteve me studentët e diplomuar dhe përdorimi i opinionit të tyre përmes konsultimeve apo sondazheve pas diplomimit, kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të programit.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	E. 1.12. Studim Tregu- Media in Fokus Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit tregon angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin dhe përditësimin e programit, duke marrë në konsideratë zhvillimet e fundit në fushën e gazetarisë dhe komunikimit, si dhe tendencat në tregun e punës. Puna bashkëpunuese me rrjete profesionistësh dhe institucione publike e private siguron që përmbajtja e programit të jetë jo vetëm akademikisht e vlefshme, por edhe praktikisht e aplikueshme. Kjo qasje është evidenaut përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe projekteve shkencore të departamentit. Evidenca 3.6. Projektet shkencore të departamentit. Programi i studimit evidenton përpjekje të qarta dhe të strukturuar për përmirësim të vazhdueshëm dhe përshtatje me kërkesat dinamike të tregut të punës dhe zhvillimet në fushën përkatëse. Njësia përgjegjëse angazhohet në konsultime të rregullta me aktorë të jashtëm, përfshirë institucione partnere, të diplomuar dhe përfaqësues të fushave profesionale, duke reflektuar sugjerimet e tyre në përmbajtjen dhe orientimin e programit.			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit "Qemal Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43123

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit “Gazetari dhe Komunikim” pasqyron një qasje të shumëllojshme dhe bashkëkohore në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit, ku përfshihen format tradicionale si leksionet dhe seminarët, si edhe komponentë më praktikë dhe interaktivë si punët laboratorike, detyrat e kursit, esetë, projektet dhe praktikat profesionale. Kjo shumëllojshmëri metodash siguron përfshirjen aktive të studentit në procesin e të nxënit dhe përmbushjen e objektivave të formimit të tyre teorik e praktik. Zbatimi i formave alternative si orët e hapura, debatet apo projektet ndërdisiplinore reflekton përpjekjet e institucionit për të integruar metoda mësimore që i vënë studentët në qendër të procesit edukativ, duke nxitur mendimin kritik, punën në grup dhe zgjidhjen e problemeve reale. <i>E. 1.8. a. Plani mësimor / Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit aplikon metoda të ndryshme mësimdhënieje dhe forma alternative të përfshirjes në procesin e të nxënit duke përmbushur nevojat e studentëve. Përdorimi i metodave të ndryshme të komunikimit dhe vlerësimit ndihmon në përfshirjen e studentëve me lloje të ndryshme të të nxënit. <i>E. 2.1. Syllabuset e lëndëve</i> <i>E. 2.1.a. Format i syllabusit</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Institucioni i arsimit të lartë tregon një angazhim të qartë për të mbështetur zhvillimin profesional të stafit akademik, veçanërisht në aspektin e përmirësimit të kompetencave didaktike. Kjo mbështetje realizohet përmes pjesëmarrjes në projekte shkencore, shkëmbime Erasmus+, trajnime pedagogjike, seminare të brendshme ose të jashtme, si dhe përmes aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të lidhura me mësimdhënien dhe përmirësimin e metodave mësimore. <i>E. 3.6. Projektet shkencore të departamentit</i> <i>E. 6.9. Revista e Departamentit/Fakultetit “Studime Albanologjike”</i> <i>E. 4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i> <i>E. 3.11. Listë trajnimesh prej Zyrës së Këshillimit të Karrierës</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit ka një staf me kapacitete dhe aftësi të larta profesionale, me tituj e grada shkencore. Kjo është një ndër pikat më të forta të programit të studimit. Personeli akademik i përfshirë në programin e studimit përdor metodave të ndryshme të mësimdhënies interaktive, si diskutimet, punët në grup, analizat e rasteve, produksionet mediatike, si dhe metoda të tjera të cilat përputhen me parimet e të nxënit aktiv dhe me qasjen me në qendër studentin.

mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Stafi nxit zhvillimin e mendimit kritik, krijues dhe të pavarur, duke kontribuar në formimin e aftësive intelektuale dhe profesionale të studentëve. Për më tepër, ndërtohen marrëdhënie të qëndrueshme respekti dhe bashkëpunimi, të cilat u konfirmuan nga studentët edhe gjatë vizitës në institucion. <i>E. 2.2. CV e stafit akademik me kohë të plotë të ngazhuar në programin e studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 2.2. a. CV e stafit akademik me kohë të pjesshme të ngazhuar në programin e studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit dhe njësitë e sigurimit të cilësisë në UT aplikojnë vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies, duke përfshirë si instrumente kryesore feedback-un nga studentët, mbledhjet konsultative dhe anketimet vjetore. Ky vlerësim shërben si bazë për përmirësimin e përmbajtjes didaktike dhe përshtatjen e qasjeve mësimore me nevojat aktuale të studentëve dhe kërkesat e tregut të punës. <i>E. 6.6. Raporti i Vlerësimit të lëndëve nga pyetësi i studentëve</i> <i>E. 6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E. 6.2. Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së</i> <i>E. 6.10. Analiza e Pyetësorëve</i> <i>E. 6.6. Raporti i Vlerësimit të lëndëve nga pyetësi i studentëve.</i> <i>E. 5.1. Analiza e Departamentit për objektivat formues të programit të studimit</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të	Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë kanë krijuar struktura dhe njësi të dedikuara të sigurimit të cilësisë së brendshme në nivel institucional dhe fakulteti të cilat promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe koordinojnë aktivitetet me njësitë përgjegjëse për programin e studimit. Megjithatë, nuk dokumentohet qartë se si këto struktura mbështesin eksperimentimin dhe zbatimin e metodave të reja inovative, duke nxitur një ambient që nxit kreativitetin dhe përmirësimin pedagogjik. Sugjerohet që institucioni të forcojë rolin e strukturave të sigurimit të cilësisë në identifikimin, dokumentimin dhe shpërndarjen e praktikave të mira mësimdhënieje, si dhe të nxisë në mënyrë të qëllimshme eksperimentimin me metoda inovative dhe teknologji të reja mësimore. Kjo mund të realizohet përmes trajnimeve të dedikuara, iniciativave pilot në kuadër të njërive bazë dhe vlerësimit sistematik të ndikimit të këtyre qasjeve në përvojën e të nxënës. <i>E. 6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>



mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.				
Konkluzione	<i>Institucioni demonstroi një angazhim të fortë për të siguruar një proces mësimor të orientuar nga studentët, duke përdorur forma dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies që nxisin mendimin kritik, krijues dhe autonomi. Personeli akademik është kompetent dhe i përkushtuar për të zhvilluar mësimin në mënyrë interaktive dhe për t'i dhënë rëndësi diversitetit të nevojave të studentëve, duke ofruar mundësi alternative dhe mbështetje të vazhdueshme.</i> <i>Në kuadrin e promovimit të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe bashkërendimit të punës me njësitë e posaçme, rekomandohet dokumentimi më i detajuar se si këto struktura mbështesin eksperimentimin dhe zbatimin e metodave të reja inovative, të forcohet roli i strukturave të sigurimit të cilësisë në identifikimin, dokumentimin dhe shpërndarjen e praktikave të mira mësimdhënieje.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni ka hartuar rregullore të qarta dhe procedura të detajuara për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve, të cilat janë pjesë e dokumentacionit zyrtar të programit të studimit. Këto rregullore janë të publikuara dhe studentët informohen dhe njihen me to që në fillim të procesit arsimor, duke garantuar një proces transparent në vlerësimin akademik. <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit në Gazetari dhe Komunikim që në fillim të secilës lëndë ose modul informojnë studentët në mënyrë të detajuar mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Ky proces konsiderohet thelbësor për të krijuar pritshmëri të qarta dhe për të mundësuar përgatitjen e duhur të studentëve gjatë gjithë semestrit, si dhe për të shmangur çdo keqkuptim apo pasiguri në lidhje me kriteret e vlerësimit. <i>E. 2.1. Syllabuset e lëndëve</i> <i>E. 2.1.a. Format i syllabusit.</i> <i>E. 6.1. Rregullore e Sigurimit të Cilësisë në UT</i>

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit përdor një gamë të gjerë metodash të testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore, duke përfshirë mënyra të ndryshme si provime të ndërmjetme dhe përfundimtare, produksione mediatike që zhvillohen nga studentët në atelietë e mediave në institucion, projekte, ese, prezantime, praktika profesionale dhe aktivitete të tjera interaktive. Përdorimi i metodave të ndryshme vlerësimi kontribuon në një proces gjithëpërfshirës, duke u siguruar që njohuritë dhe aftësitë të matën në mënyrë të saktë dhe të përshtatshme me natyrën e lëndës dhe objektivat e saj. <i>E. 2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia bazë dhe personeli akademik janë aktivë në vlerësimin dhe përmirësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies, duke i kushtuar rëndësi të veçantë përfshirjes së studentëve në këtë proces. Përfshirja e studentëve, përmes anketimeve, grupeve fokus dhe diskutimeve të hapura, lejon marrjen e feedback-ut të drejtpërdrejtë mbi efektivitetin e metodave të përdorura dhe identifikimin e mundësive për përmirësim. Kjo qasje promovon një ambient mësimor më adaptiv dhe interaktiv, ku metodat mësimore përshtaten vazhdimisht për të përmbushur më mirë nevojat dhe pritshmëritë e studentëve, si dhe për të përmirësuar cilësinë e procesit të të nxënës. <i>E. 6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E. 6.6. Raporti i Vlerësimit të lëndëve nga pyetësi i studentëve</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit promovon përdorimin e metodave të ndryshme dhe fleksible pedagogjike që janë të përshtatura me rezultatet e pritshme të të nxënës dhe objektivat formues të programit. Metodatat e mësimdhënies nxisin autonominë e studentit, si dhe krijon një ambjent mësimor fleksibël që i përshtatet nevojave të studentit. <i>E. 6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatom se ky standard është përmbushur plotësisht. Institucioni ka krijuar një kornizë të qartë dhe</i>



	të strukturuar për vlerësimin dhe testimin e njohurive dhe aftësive të studentëve, e cila bazohet në rregullore të miratuara dhe të njohura nga të gjithë aktorët përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Ky kriter është i realizuar. Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale gjatë gjithë vitit akademik përfaqëson një praktikë të mirë të njësisë bazë e cila nxit procesin e të nxënës në mënyrë të vazhdueshme dhe shmang përqendrimin e gjithë vlerësimit vetëm në provimin përfundimtar. <i>E. 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit ka marrë të gjitha masat e duhura të cilat shmangin format e abuzimit. Edhe pse testimi kryhet në formë tradicionale dhe format e testimit nëpërmjet sistemeve elektronike nuk aplikohen në mënyrë të gjerë, mekanizmat e zbatuara në praktikë sigurojnë transparencën. <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës është në përputhje të plotë me syllabusin dhe kuadrin ligjor në fuqi. Kjo garanton që çdo student të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara paraprakisht. <i>E. 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar	Stafi akademik dhe koordinatori i studimit asistojnë studentët në të gjitha fazat që lidhen me procesin e të nxënës. Kjo qasje ndihmon studentin të kuptojë më mirë pikat e forta dhe dobësitë e tij, duke i dhënë mundësi që të punojë në mënyrë më efektive për përmirësimin e njohurive dhe aftësive profesionale. Këshillat e lidhura me procesin e të nxënës u konsideruan nga studentët gjatë vizitës studimore si një vlerë e shtuar e këtij programi studimi.

studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<i>E. 1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit, si dhe akte të tjera ligjore që lidhen me ndershmërinë akademike, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit si dhe personeli akademik ndjekin politika dhe mekanizma të qarta për identifikimin dhe trajtimin e plagjiaturës dhe shkeljeve të tjera. Studentët informohen lidhur me këto shkelje të rënda që në fillim të vitit akademik, si dhe udhëzohen në vijimësi mbi parimet e ndershmërisë dhe punës studentore. <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 6.11. Kodi i etikës së UT-së</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit siguron që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të bazohen në parimet e meritës, transparencës dhe barazisë. Procesi i vlerësimit zbatohet në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në rregulloret përkatëse të Universitetit të Tiranës dhe të programit të studimit. Studentët informohen paraprakisht për kriteret e vlerësimit dhe format e provimeve, ndërsa rezultatet shpallen në kohë përmes platformave zyrtare, duke garantuar akses të barabartë dhe të drejtë për të gjithë. Po ashtu, është e mundur përparaqitja e ankesave dhe kërkesave për rishikim të notës, në përputhje me mekanizmat institucionalë të ankimimit. <i>E. 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni siguron të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin e tyre dhe për të kërkuar rishikim në mënyrë të qartë dhe të drejtë. Ky proces është i përcaktuar rregulloren e programit të studimit, si dhe rregulloren e universitetit. Në këto rregullore parashikohen procedura të detajuara, duke garantuar që studentët të kenë mundësi për ri-vlerësim në rast mosdakordësie. <i>E. 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit zbaton në mënyrë të rregullt dhe të dokumentuar procedurat për shqyrtimin e çdo kërkesë apo ankimi nga studentët, në përputhje me Rregulloren e Universitetit të Tiranës dhe Rregulloren e Programit të Studimit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim". Çdo ankesë shqyrtohet fillimisht nga komisioni i vlerësimit dhe, në rast nevojë, nga një komision i posaçëm i ngritur ad hoc. Procedura është transparente, përfshin njoftimin e palëve të

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	interesuara për vendimet e marra dhe dokumentohet në mënyrë zyrtare, duke u arkivuar pranë sekretarisë mësimore dhe strukturave përgjegjëse. Kjo praktikë garanton respektimin e të drejtave të studentëve dhe rrit besimin në integritetin e procesit të vlerësimit akademik. <i>E. 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni garanton një proces vlerësimi që karakterizohet nga drejtësia, transparenca dhe objektiviteti, duke u bazuar në meritën dhe performancën reale të çdo studenti. Sistemet dhe procedurat e vlerësimit janë të qarta dhe të aksesueshme për studentët, të cilët informohen në mënyrë të plotë për kriteret dhe mënyrat e vlerësimit që do të aplikohen gjatë gjithë periudhës së studimeve. Institucioni gjithashtu siguron një mekanizëm të mirëorganizuar dhe transparent për trajtimin e ankimeve nga studentët, duke garantuar që çdo shqetësim të shqyrtohet në mënyrë objektive dhe me respekt ndaj të drejtave të studentëve. Kjo qasje kontribuon në krijimin e një mjedisi të besueshëm akademik, ku studentët ndihen të mbështetur dhe të motivuar për të arritur rezultate cilësore, ndërsa institucionet forcojnë integritetin dhe kredibilitetin e procesit arsimor. Për më tepër, mekanizmat e vlerësimit dhe ankimit reflektojnë angazhimin e institucionit për përmirësim të vazhdueshëm dhe zhvillim profesional të personelit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit është konceptuar në mënyrë që të sigurojë një thellim të qëndrueshëm dhe të strukturuar të njohurive në fushën përkatëse, duke përfshirë elementë teorikë dhe praktikë që mbështesin zhvillimin e aftësive profesionale. Një fokus i veçantë është vënë në aftësitë e veçanta që kërkohen nga tregu i punës dhe standardet ndërkombëtare, duke e bërë programin të përshtatshëm për formimin e profesionistëve kompetentë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, intervistat me personelin akademik dhe studentët, rezultojnë se programi përmbush këto kriter. <i>E. 1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit,	Programi i studimit ka potencial për zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha kyçe si teknologjia e informacionit, aspektet humane dhe sociale, si dhe në komunikim dhe ndërveprim. Struktura e programit, nëpërmjet punëve praktike në laboratorët e medias nxit zhvillimin në aftësitë teknologjike të informacionit. Gjithashtu, në analizën e materialeve të

humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	programit dhe diskutimet me stafin dhe studentët, vërehet përdorimi i metodave interaktive dhe praktikave që promovojnë aftësitë sociale dhe teknologjike, të domosdoshme për punësim dhe zhvillim profesional. <i>E. 1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Programi i studimit dhe syllabuset e secilës lëndë përmbajnë një përshkrim të qartë të kompetencave dhe aftësive që studenti pritët të fitojë. Në përfundim të secilës lëndë, personeli akademik angazhohet në analizimin dhe shqyrtimin e këtyre kompetencave me studentët, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme të materialit të përvetësuar. Udhëzimet dhe orientimet për zbatimin praktik të njohurive dhe përmbylljes së detyrimeve përmbyllëse janë të strukturuar dhe të përshtatura për të ndihmuar studentët në integrimin dhe aplikimin e njohurive në mënyrë efektive. <i>2.1. Syllabuset e lëndëve</i> <i>E. 6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E. 6.6. Raporti i Vlerësimit të lëndëve nga pyetësi i studentëve</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia në program është e fokusuar në zhvillimin e kompetencave praktike dhe teorike të studentëve, duke u dhënë atyre mundësi konkrete për të aplikuar njohuritë në laboratorë dhe gjatë praktikave profesionale. Personeli akademik përdor metoda aktive të mësimdhënies, duke inkurajuar diskutime dhe punë në grup, që promovojnë analizën kritike dhe zgjidhjen kreative të problemeve. Krijohet një ambient stimulues ku nxisen idetë inovative dhe hulumtimet kërkimore e shkencore, dhe mbështeten përpjekjet e studentëve në këto drejtim. Gjithashtu, bashkëpunimi me institucionet partnere është i zhvilluar, duke ofruar mundësi të mira për mobilitet studentor. <i>E. 2.2. CV e stafit akademik me kohë të plotë të ngazhuar në programin e studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 2.2. a. CV e stafit akademik me kohë të pjesshme të ngazhuar në programin e studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 3.6. Projektet shkencore të departamentit</i> <i>E. 6.9. Revista e Departamentit/Fakultetit "Studime Albanologjike"</i> <i>E. 1.9. Marrëveshjet e Bashkëpunimit</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja	Organizimi i orëve të hapura dhe seminareve mbi tematika të ndryshme që përfshijn zhvillimet teknologjike në fushën e medias dhe zhvillime të tjera në shkencë është një praktikë e konsoliduar në departamentin e



të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Gazetarisë dhe Komunikmit. Gjithashtu, në kuadër të partneriteteve të ndryshme zhvillohen leksione të hapura me pedagogë të ftuar. Ky kriter konsiderohet i realizuar.			
Konkluzione	<i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i>			
	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se institucioni ka ngritur struktura funksionale në nivel institucional që promovojnë vetëdijen dhe angazhimin për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit, në përputhje me kuadrin rregullator dhe objektivat formues akademike. Ky kriter është përmbushur plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Institucioni ka krijuar dhe miratuar rregullore të posaçme që rregullojnë procesin e provimit përfundimtar dhe përgatitjen e punimit të diplomës, duke siguruar një kuadër të qartë dhe transparent për studentët. Në rregulloren e programit të studimit është përcaktuar në mënyrë të qartë pragu minimal i notës mesatare që duhet të ketë studenti për të fituar të drejtën për të filluar punimin e diplomës. Po ashtu, duke e bërë këtë informacion publik, institucioni siguron që studentët të jenë të informuar për kriteret që duhet të përmbushin. <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 3.3. Material udhëzues për punimin e diplomës, BA</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Strukturat përgjegjëse në institucion, si dhe personeli akademik, ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë gjithë procesit të përgatitjes dhe realizimit të detyrimeve përmbyllëse, duke përfshirë punimin e diplomës ose provimin përfundimtar. Kjo mbështetje përfshin dhënien e informacionit të qartë dhe të plotë lidhur me kërkesat, afatet dhe procedurat që duhet të ndiqen, si dhe udhëzime praktike për hartimin e punimeve shkencore, metodologjinë e kërkimit, referencimin e literaturës dhe përdorimin e burimeve akademike. Personeli akademik është i gatshëm të ofrojë konsultime individuale dhe grupe për të adresuar pyetjet dhe vështirësitë që hasin studentët gjatë këtij procesi. Përveç kësaj, institucioni siguron qasje në materialet mësimore dhe teknologjitë e nevojshme, duke lehtësuar kështu realizimin cilësor të detyrimeve përmbyllëse.

	<i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në këtë program studimi nuk aplikohet provimi përfundimtar. <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Personeli akademik, në rolin e udhëheqësit të punimit të diplomës, ka një rol kyç në mbështetjen dhe udhëheqjen e studentëve gjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit përmbyllës. Ai orienton studentët në zgjedhjen e temave relevante, që janë në përputhje me fushën studimore dhe interesat kërkimore, duke siguruar që temat të jenë sfiduese dhe me vlerë akademike e praktike. Udhëheqësi ndihmon në organizimin dhe përpunimin e të dhënave, nxjerrjen e rezultateve dhe interpretimin e tyre, duke ofruar mbështetje metodologjike dhe shkencore gjatë të gjithë procesit. Gjithashtu, ai monitoron vazhdimisht cilësinë e punimit dhe siguron që puna të përmbushë standardet akademike dhe kërkesat e udhëzuesve të miratuar. <i>E. 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se ky kriter është i realizuar. Njësia bazë asiston studentët në zhvillimin e praktikave, analizave dhe projekteve studimore, duke vënë në dispozicion infrastrukturë bashkëkohore dhe mjedise të përshtatshme brenda institucionit, në përputhje me objektivat e programit të studimit në fushën e gazetarisë dhe komunikimit. <i>E. 4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se ky kriter është i realizuar. Në përfundim të mbrojtjes së diplomës studenti vlerësohet me notë dhe me kreditë ETCS. <i>E. 1.6 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për	Institucioni siguron që në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës, dokumente këto të standardizuara dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Institucioni pajis çdo student me një kopje të plotë dhe zyrtare të



arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	programit të studimit të zhvilluar gjatë ciklit akademik, duke siguruar mundësi të plotë për verifikim të përmbajtjes së arsimit të ndjekur. <i>E. 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>E. 1.5. Rregullore e Departamentit të Gazetarisë</i> <i>E.3.5. Formati i diplomës dhe suplementi i saj</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësi të ruajë me kujdes dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të gjithë dokumentacionin lidhur me studentët, duke garantuar sigurinë, privatësinë dhe aksesin e kontrolluar në këto të dhëna. Kjo përfshin dosjet akademike, rezultatet, dokumentet personale dhe çdo informacion tjetër relevant që lidhet me përparimin dhe statusin e studentit. Për më tepër, institucioni është i detyruar të ofrojë informacione të nevojshme dhe të autorizuar për studentin, apo palët e tjera të interesuara, në mënyrë të saktë dhe në kohë, duke ndjekur procedurat e përcaktuara ligjore dhe rregulloret institucionale. Kjo praktikë ndihmon në mbështetjen e të drejtave të studentëve dhe në sigurimin e transparencës dhe besueshmërisë së institucionit në proceset administrative dhe akademike. <i>E. 1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.4.3. Rregulla të sekretarisë mësimore</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe të strukturuar për realizimin e detyrimeve përmbyllëse të studentit, duke garantuar pajisjen në kohë dhe me transparencë me dokumentacionin përkatës të diplomimit, në përputhje me rregulloret institucionale. Ky standard vlerësohet i përmbushur plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit akademik dhe përputhshmërinë me fushat e kompetencës, natyrën dhe veçoritë e moduleve të programit. Në realizimin e këtij programi janë të angazhuar gjithsej 20 staf akademik (PAE+PAK) 2022-2023 18 PAE/2 PAK 2023-2024 18 PAE/2 PAK 2024-2025 18 PAE/2 PAK Njësia bazë, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit gjatë tre viteve të fundit ka një pasur një qëndrueshmëri në numrin e staf akademik efektiv me një numër prej 17 anëtarësh, prej të cilëve 2 me titullin akademik “Profesor”, 7 me titullin akademik “Profesor i Asociuar”, 6 me gradën shkencore “Doktor i Shkencave”, 2 asistentë lektorë me nivel “Master i Shkencave”. Ky departament evidenton dhe administron të dhënat për kualifikimet, fushën e specializimit, titullin akademik, gradën shkencore, si dhe përvojën kërkimore ose praktike të stafit, duke siguruar mbulimin e lëndëve/moduleve në përputhje me profilin profesional të secilit. Po ashtu, departamenti organizon dhe dokumenton ndarjen e ngarkesës mësimore dhe angazhimin e stafit në veprimtari të tjera akademike përgjatë vitit, të cilat përcillen në mënyrë të strukturuar pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë administron proceset e rekrutimit, kontraktimit dhe verifikimit të përmbushjes së kërkesave ligjore për angazhimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik, në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe standardet përkatëse të cilësisë. <i>Evidenca E.1.15 Lista e PAE</i> <i>E.2.2. CV e stafit akademik me kohë të plotë të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Gazetari dhe Komunikim</i> <i>E.2.2.a. CV e stafit akademik me kohë të pjeshme të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Gazetari dhe Komunikim</i> <i>E.4.1. Rregulla të Zyrës së Burimeve Njerëzore, FHF</i> <i>E.4.2. Format i Dosjes personale të stafit akademik</i> <i>E.4.6. Manuali për punësimin e stafit të UT-së</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Bazuar në evidencën E.1.8 “Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në Gazetari dhe Komunikim”, miratuar nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit dhe i dorëzuar në instancat përkatëse për miratim, rezulton se programi është hartuar dhe strukturuar në përputhje me standardet akademike dhe kornizën ligjore në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Plani mësimor parashikon shpërndarjen e ngarkesës prej 180 kreditesh ECTS të ndara në mënyrë të balancuar përgjatë tre viteve akademike dhe është hartuar nga një grup pune i



	specializuar, i përbërë nga staf akademik me kompetenca profesionale në fushën e gazetarisë dhe komunikimit, të miratuar nga Departamenti në mbledhjen e datës 18 shtator 2019. Procesi i hartimit ka qenë gjithëpërfshirës, duke përfshirë diskutime me ekspertë të jashtëm vendas dhe ndërkombëtarë, si dhe me përfaqësues të studentëve, çka ka garantuar përputhjen e përmbajtjes me kërkesat aktuale të tregut të punës dhe zhvillimet bashkëkohore të fushës. Mbulimi i ngarkesës mësimore realizohet në përputhje me kornizën ligjore dhe kërkesat institucionale për përbërjen e stafit. Nga 22 pedagogët e angazhuar në programin e studimit: • 77% janë pjesë e njësisë bazë, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit; • 14% janë staf nga njësia kryesore (Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, UT); • 9% janë pedagogë të kontraktuar nga jashtë Universitetit të Tiranës. Kjo përbërje e stafit garanton një mbulim të qëndrueshëm dhe të balancuar të lëndëve dhe moduleve nga personel akademik i kualifikuar, në përputhje me profilin e programit dhe natyrën e lëndëve. Nga analiza e planit mësimor për vitin akademik 2024–2025, struktura e programit rezulton si vijon: • Lëndë Bazë (A): 33 ECTS ≈ 18% • Lëndë Karakterizuese (B): 94 ECTS ≈ 52% • Lëndë Ndërdisciplinare/Integruese (C): 28 ECTS ≈ 15% • Lëndë Plotësuese/Formuese (D): 17 ECTS ≈ 10% • Punim diplome/provim përfundimtar: 8 ECTS ≈ 4% Lëndët që mbulohen nga staf akademik jashtë Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, përfshijnë: • Gjuha angleze për gazetarë • Kushtetuta dhe sistemi politik në Shqipëri për gazetarë • Albanologji për gazetarë • Ligji për median, liria e shprehjes dhe informimit • Sport Ky angazhim i përzgjedhur i stafit nga njësi të tjera ose me kontratë ndihmon në mbulimin e moduleve ndërdisciplinare apo ndihmëse që nuk bëjnë pjesë drejtpërdrejt në thelbin e gazetarisë, por që kontribuojnë në formimin e gjerë profesional të studentëve, në përputhje me objektivat e programit. <i>E.1.8 Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në Gazetari dhe Komunikim</i> <i>E.1.15 Lista e PAE</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë	Institucioni garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gazetari dhe

qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Komunikim”, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Nga të dhënat zyrtare dhe dokumentacioni i administruar nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, rezulton se personeli i angazhuar në këtë program përbëhet në masën dërrmuese nga staf akademik efektiv, me kontrata të rregullta pune në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe me rregulloret e brendshme të Universitetit të Tiranës. Kontratat e punës janë të dokumentuara dhe përfshijnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit, duke përfshirë pagesat për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi. Administrimi i këtyre kontratave, si dhe ndjekja e vazhdueshme e statusit të punësimit të stafit bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila mban të azhurnuar evidencën për secilin anëtar të stafit akademik dhe ndihmës akademik. Përbërja aktuale e stafit (77% nga njësia bazë, 14% nga njësia kryesore, 9% me kontratë nga jashtë) garanton që programi të ketë një strukturë të qëndrueshme dhe funksionale në mbështetje të zhvillimit të tij gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit. <i>E.1.15 Lista e PAE</i> <i>E.4.1. Rregulla të Zyrës së Burimeve Njerëzore, FHF</i> <i>E.4.6. Manuali për punësimin e stafit të UT-së</i> <i>E. 2.4. Model kontrate PAE, kategoria 'Profesor'</i> <i>E.2.5 Model kontrate PAK</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik, të bazuara në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara, në përputhje me natyrën dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”. Rekrutimi dhe përzgjedhja e stafit akademik realizohet në përputhje me Manualin për punësimin e stafit akademik të Universitetit të Tiranës, si dhe me Rregulloren e Zyrës së Burimeve Njerëzore të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë (FHF). Këto dokumente përcaktojnë qartësisht procedurat e hapjes së vendeve të punës, kriteret e përzgjedhjes, përbërjen e komisioneve vlerësuese dhe dokumentacionin e nevojshëm për çdo fazë të rekrutimit. Për më tepër, neni 13 i Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” përcakton kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për përbërjen e stafit akademik, duke përfshirë kërkesat për nivelin e kualifikimit apo përvojën si specialist në një lëndë të caktuar, si dhe përputhshmërinë me strukturën dhe përmbajtjen e moduleve që ofron programi. Rregullorja parashikon gjithashtu kushtet specifike të punësimit në këtë program, duke siguruar që çdo anëtar i stafit të jetë në

	përputhje me natyrën akademike dhe praktike të fushës së gazetarisë dhe komunikimit. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E.4.1. Rregulla të Zyrës së Burimeve Njerëzore, FHF</i> <i>E.4.6. Manuali për punësimin e stafit të UT-së</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni siguron angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e komponentëve praktikë të programit të studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim", në përputhje me natyrën e tij aplikative dhe kërkesat teknike që rrjedhin nga lëndët me përmbajtje laboratorike dhe praktika profesionale. Bazuar në nenin 9 të Rregullores së programit të studimit, që përcakton strukturën organizative dhe drejtuese, për çdo laborator mediatik (atelie) caktohet një pedagog përgjegjës, i cili ndjek nga afër veprimtarinë mësimore dhe mbikëqyr zhvillimin e praktikave në mjediset e posaçme. Krahas tij, është i angazhuar edhe një personel ndihmës akademik me karakter mësimor, i cili ofron mbështetje teknike dhe logjistike për funksionimin e vazhdueshëm të laboratorëve, pajisjeve audio-vizive dhe mjediseve të tjera ndihmëse të mësimdhënies. Neni 15 i Rregullores së programit të studimit parashikon detyrat e personelit ndihmës akademik me karakter mësimor (laboranti departamentit). Personeli ndihmës akademik është i kontraktuar sipas parashikimeve ligjore dhe rregulloreve të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, përfshirë përmbushjen e kushteve të punësimit dhe sigurimeve përkatëse shoqërore dhe shëndetësore. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E.2.2. CV e stafit akademik me kohë të plotë të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Gazetari dhe Komunikim</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit,	Institucioni garanton mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e rregullt të të dhënave të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim", në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me standardet e menaxhimit administrativ në arsimin e lartë. Zyra e Burimeve Njerëzore pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë mban dhe administron dosje individuale për çdo anëtar të stafit të angazhuar në program, pavarësisht nëse janë me kohë të plotë apo të pjesshme. Këto dosje përmbajnë informacion të plotë mbi nivelin e arsimit, kualifikimet akademike dhe shkencore, publikimet, informacionin shëndetësor të nevojshëm, vlerësimet nga studentët, kontratat e punës në vite dhe të dhëna të tjera që lidhen me statusin

angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	profesional dhe institucional të stafit. Fillimisht, të dhënat për personelin mbledhen dhe përpunohen në nivel departamenti nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit (njësia bazë) dhe më pas përcillen në Zyrën e Burimeve Njerëzore të fakultetit për administrim të centralizuar dhe të dokumentuar. Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstatoi se dokumentacioni për personelin është i plotë dhe i mirëstrukturuar. Nga përzgjedhja rastësore e disa dosjeve të stafit akademik (PAE dhe PAK), u verifikua se ato përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm dhe përmbushin standardet ligjore e institucionale. Për më tepër, në Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Parë janë përcaktuar qartë kriteret e nivelit të kualifikimit që duhet të plotësojë stafi akademik për t'u angazhuar në këtë program, duke ndihmuar kështu në sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me natyrën e lëndëve dhe objektivat mësimorë. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E.4.1. Rregulla të Zyrës së Burimeve Njerëzore, FHF</i> <i>E.4.2. Formati i Dosjes personale të stafit akademik</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit garanton angazhimin e personelit të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera të lidhura ngushtë me natyrën specifike të programit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim". Institucioni ka një rrjet të gjerë bashkëpunimi të formalizuar përmes 15 marrëveshjeve me institucione mediatike, autoritete rregullatore dhe aktorë të sektorit të komunikimit dhe medias, të cilat mundësojnë integrimin praktik të studentëve në ambiente profesionale. Ndër këto bashkëpunime spikat marrëdhënia e konsoliduar shumëvjeçare me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), e cila është materializuar në një sërë projektsh kërkimore, monitoruese dhe zhvillimore në fushën e politikave mediatike, dixhitalizimit, cilësisë së transmetimeve, audiencave dhe sfidave të epokës post-digjitale. Këto projekte janë realizuar në mënyrë të vazhdueshme nga DGK me mbështetje financiare dhe teknike nga AMA, OSBE, Bashkimi Evropian, UNDP dhe partnerë të tjerë institucionalë. Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, studentët përfshihen në mënyrë aktive në projekte kërkimore dhe praktika profesionale të udhëhequra nga staf i specializuar i departamentit dhe nga profesionistë të jashtëm të fushës. Gjithashtu, marrëveshjet përfshijnë angazhimin e institucioneve pritëse në mbikëqyrjen dhe mentorimin e studentëve gjatë praktikës, në përputhje me objektivat e modulit përkatës.

	Programi përfiton gjithashtu nga bashkëpunimi ndërkombëtar me universitete të huaja, si në rastin e projektit Erasmus+ "Fakespotting", i realizuar në partneritet me Universitetin e Bolonjës dhe universitete të tjera europiane. Ky bashkëpunim ndërkombëtar i ka ofruar studentëve dhe stafit mundësi për shkëmbim eksperience, qasje në trajnim dhe kërkime bashkëkohore, si dhe përfshirje në iniciativa transnacionale që lidhen me edukimin mediatik dhe luftën kundër dezinformimit. Ky rrjet bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar, i shoqëruar me një strukturë të mirëpërcaktuar të përfshirjes së personelit të kualifikuar, garanton një mbështetje të plotë dhe efektive për zhvillimin profesional të studentëve dhe për përmbushjen e objektivave të programit të studimit, në përputhje me standardet akademike dhe nevojat e tregut të punës. Edhe pse institucioni gëzon një marrëdhënie të konsoliduar bashkëpunimi me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), rekomandohet që të rishikohet dhe të zgjerohet gama e bashkëpunimeve me aktorë të tjerë institucionalë, përfshirë agjencitë e pavarura të komunikimit, organizatat jofitimprurëse dhe partnerë ndërkombëtarë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit. <i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Bazuar në nenin 30 të Rregullores së Programit të Studimit, praktika mësimore zhvillohet në mjediset e Media-Lab të departamentit, si dhe në institucionet partnere me të cilat DGK ka marrëveshje të posaçme për kryerjen e praktikës nga studentët. Në këto institucione, studentët angazhohen nën kujdesin dhe udhëzimin e një personeli mbikëqyrës të caktuar, i cili ka për detyrë të orientojë zhvillimin e praktikës dhe të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga programi i praktikës. Personeli mbikëqyrës mbështet studentët në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës, duke u siguruar që përvoja e përfutur të reflektohet në mënyrë të strukturuar dhe sipas objektivave të programit. Gjithashtu, ky personel merr pjesë në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit të praktikës profesionale, përmes vlerësimeve individuale që përcillen te pedagogu përgjegjës, i cili integron këtë feedback në notën përfundimtare të studentit. Kjo qasje e dyanshme, akademike dhe institucionale, siguron një përvojë të plotë mësimore për studentët, duke i lidhur ata me realitetin e tregut të punës dhe duke përfshirë aktorët e jashtëm në procesin e formimit dhe vlerësimit të tyre profesional, në përputhje me standardet e cilësisë në arsimin e lartë. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>

Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, bazuar në analizën e dokumentacionit të dorëzuar, intervistat me aktorët institucionalë dhe verifikimet në terren, konstaton se programi i studimit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim" përmbush plotësisht Standardin IV.1. Personeli akademik i angazhuar në këtë program përmbush kërkesat sasiore dhe cilësore, duke përfshirë numrin e nevojshëm të pedagogëve me angazhim të qëndrueshëm dhe me kualifikim të përshtatshëm akademik e profesional, në përputhje me fushat e mbulimit të lëndëve dhe objektivat e programit. Staf i përbëhet nga pedagogë të Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit (njësia bazë), ndërsa për lëndët ndërdisiplinare ose mbështetëse është angazhuar staf nga njësia kryesore ose me kontratë nga jashtë, duke respektuar balancën institucionale dhe ligjore. Përbërja e stafit garanton zhvillimin e procesit të mësimdhënies në përputhje me standardet akademike, strukturën e planit mësimor dhe natyrën specifike të moduleve, duke siguruar cilësi, qëndrueshmëri dhe koherencë në zbatimin e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni garanton mjediset e mjaftueshme dhe funksionale për zhvillimin e programit të studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim", në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe natyrën specifike të moduleve të përfshira në planin mësimor. Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, si njësi bazë e programit, ka në përdorim një sërë ambientesh të dedikuara për mësimdhënie, punë praktike, laboratorike dhe veprimtari administrative. Mjediset në dispozicion përfshijnë: 2 auditorë me kapacitete të përshtatshme për leksione të përgjithshme: - Auditori 1-303 (20 m²) - Auditori 311 (75 m²) Labororë të specializuar për gazetari dhe media që mbulojnë komponentët praktikë të programit, si: - Laboratorët 317, 318, 318/1, 319 dhe 326 me sipërfaqe nga 18 m² deri në 50 m² - Laboratori i Radios (305) me sipërfaqe 25 m² - 1 laborator multimedial i avancuar (321), me sipërfaqe 54 m², i përshtatshëm për trajnime në redaktim audio-viziv, gazetari digjital dhe simulime redaksionale.

	Zyra për personelin akademik dhe drejtues, përfshirë zyrën e përgjegjësit të departamentit (321/1 – 10 m²) dhe ambiente të tjera pune (si zyrat 318/1 dhe 319). DGK ka në dispozicion edhe ambiente të tjera shtesë, përfshirë: - 85 m² zyrë (administrator) - 95 m² auditor - 197 m² laborator i integruar i tipit “open media lab”, i përshtatur për praktika profesionale, produksion dhe trajnim të specializuar. Këto mjedise janë të pajisura me teknologji bazë për zhvillimin e mësimin teorik dhe praktik, si pajisje për regjistrim dhe transmetim audio-viziv, kompjuterë, softuer redaktimi, si dhe mjete të tjera didaktike që mbështesin mësimdhënien bashkëkohore në fushën e gazetarisë dhe komunikimit. Në përputhje me numrin e studentëve të regjistruar dhe ndarjen në grupe mësimore, ambientet e mësimdhënies ofrojnë kapacitet të mjaftueshëm për të garantuar zhvillimin normal të procesit akademik. Shpërndarja e moduleve sipas hapësirave mësimore është në përputhje me natyrën teorike ose praktike të tyre, duke siguruar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e kompetencave akademike dhe profesionale të studentëve. <i>E.4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit disponon laboratorë të specializuar për gazetari dhe media, të pajisur me kompjuterë, softuer profesional për redaktim dhe prodhim audio-viziv, kamera profesionale, mikrofona, pajisje regjistrimi dhe serverë për ruajtje materiale, që përdoren në lëndë praktike si: shkrimi për mediat audiovizive dhe online, ueb media lab, redaktim në media, social media lab, etj. Laboratori i Media Lab është i pajisur me kabina izolimi akustik, pajisje për transmetim dhe stacione pune që simulojnë kushte reale të redaksive mediatike. Auditorët dhe klasat janë të pajisura me pajisjet e nevojshme që ndihmojnë në zhvillimin e leksioneve me mjete digjitale dhe në përdorimin e platformave ndërvepruese. Gjithashtu, ambientet e mësimdhënies janë të mbështetura nga sisteme për mësim në distancë dhe komunikim online nëpërmjet platformave si Microsoft Teams, të integruara për lehtësimin e aksesit dhe ndarjes së materialeve mësimore, veçanërisht në lëndët që përfshijnë komponentë kërkimorë dhe ndërveprim në kohë reale. Përmes këtyre infrastrukturave dhe mjeteve teknologjike, programi siguron kushte optimale për realizimin e mësimin teorik dhe praktik, duke krijuar një përvojë të plotë mësimore për studentët dhe duke



	mbështetur zhvillimin e kompetencave të nevojshme për tregun bashkëkohor të medias dhe komunikimit. <i>E.4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i> <i>E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score</i> <i>E.2.10. Manual përdorimi i sistemit e-Student</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka evidentuar se Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit disponon laboratorë të specializuar që mbulojnë një gamë të gjerë aftësish profesionale në fushën e gazetarisë dhe medias. Këto përfshijnë: - Laboratorin e Radios, të pajisur me mikrofona profesionale, miksera zëri, pajisje regjistrimi dhe transmetimi, që i shërbejnë zhvillimit të moduleve të gazetarisë radiofonike dhe edukimit të zërit. - Media Lab-in multimedial, me kompjuterë të pajisur me softuerë të specializuar për montazh video (Adobe Premiere), redaktim audio (Audacity), dizajn grafik (Photoshop), si dhe me kamera profesionale dhe pajisje ndriçimi për gazetari vizuale dhe prodhim përmbajtjeje multimediale. - Laboratorët e përgjithshëm të gazetarisë dhe komunikimit, të pajisur me stacione pune kompjuterike dhe akses në internet, ku zhvillohen module si gazetaria e shkruar, gazetaria digjitale, dhe teknikat e shkrimit për media të ndryshme. Mjediset e lartpërmendura janë funksionale dhe të përshtatura për punë individuale dhe në grup, duke reflektuar strukturën reale të redaksive mediatike dhe duke ndihmuar studentët të aftësohen praktikisht përmes simulimeve të situatave profesionale. Pajisjet e vendosura në këto ambiente janë në përputhje me nevojat e moduleve përkatëse dhe të standardeve të kërkuara në tregun e medias, duke garantuar përmbushjen e objektivave formues të programit dhe zhvillimin e kompetencave praktike të studentëve. <i>E.4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit disponon më shumë se një laborator të specializuar të teknologjisë së informacionit, të pajisura me kompjuterë bashkëkohorë dhe lidhje të qëndrueshme interneti, si dhe me një sërë programesh profesionale të teknologjisë së informacionit dhe medias, të nevojshme për zhvillimin e moduleve mësimore. Në laboratore, studentët kanë akses në: - Adobe Creative Suite (Photoshop, Premiere Pro, Audition) për dizajn grafik dhe montazh audio-video; - Audacity për redaktim audio; - OBS Studio për regjistrim dhe transmetim; - MS Office, Google Workspace dhe platforma për menaxhimin e dokumenteve dhe prezantimeve;

	- Qasje të rregullt në pajisje periferike (kamera, mikrofona, pajisje ndriçimi) të integruara në procesin mësimor. E.4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se institucioni përmbush plotësisht Standardin IV.2. Mjediset mësimore në dispozicion të programit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim" janë të mjaftueshme dhe të përshtatura për zhvillimin e leksioneve teorike dhe të formimit praktik të studentëve. Laboratorët e specializuar për gazetari dhe pajisjet teknologjike në përdorim (kompjutera, softuerë profesionalë për redaktim audio-viziv, pajisje për regjistrim dhe transmetim) i përgjigjen natyrës së programit dhe kërkesave të moduleve përkatëse. Infrastruktura fizike dhe teknologjike është në funksion të objektivave formues të programit dhe siguron një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e kompetencave akademike dhe profesionale të studentëve, në përputhje me natyrën mediatike, aplikative dhe ndërdisiplinare të fushës së gazetarisë dhe komunikimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Institucioni garanton aksesin e studentëve në literaturë bazë dhe ndihmëse në përputhje me programin e studimit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim", si në formë fizike ashtu edhe digjitale, në gjuhën shqipe dhe të huaj, duke siguruar përmbushjen e objektivave mësimorë dhe akademikë. Biblioteka e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, e krijuar në vitin 1969, është një nga bibliotekat më të mëdha dhe më të pasura universitare në vend, me rreth 51.000 tituj librash dhe 400 tituj periodikësh, që mbulojnë fusha si gazetaria, komunikimi, letërsia, historia, filozofia, sociologjia, psikologjia, gjuha dhe kultura. Literatura e disponueshme përfshin si botime në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhë të huaja, të cilat janë të përzgjedhura sipas nevojave të moduleve që zhvillohen në programin e studimit. Për fushën e gazetarisë dhe komunikimit, biblioteka ofron literaturë të specializuar, të përditësuar rregullisht përmes blerjeve të reja dhe donacioneve akademike, dhe është pjesë e sistemit COBISS.Net, që lejon shfletimin online të katalogut bibliografik dhe ndihmon studentët në kërkim të literaturës për përgatitjen e seminareve, eseve dhe diplomave.

	Aksesueshmëria e bibliotekës mbështetet nga një sallë leximi me mbi 70 vende, me fonde të hapura, si dhe nga një katalog elektronik në zhvillim, i cili i jep përparësi fushave më të kërkuara, përfshirë gazetarinë. Studentët dhe pedagogët janë frekuentues të rregullt të bibliotekës, e cila shërben si mbështetje themelore për procesin mësimor dhe kërkimor. Nëpërmjet këtij sistemi, programi siguron që studentët të kenë në dispozicion burimet e nevojshme për ndjekjen dhe përvetësimin e njohurive të parashikuara në planin mësimor, duke përbushur në mënyrë të plotë kërkesat e këtij kriteri. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHF</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit “Bachelor në Gazetari dhe Komunikim”, siguron përditësimin e vazhdueshëm të literaturës bazë dhe ndihmëse, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të fushës dhe nevojat akademike të studentëve. Ky përditësim realizohet përmes: - Rishikimit periodik të syllabuseve të moduleve, ku përfshihen botime të viteve të fundit dhe materiale akademike të përditësuara; - Blerjeve vjetore të literaturës së re dhe përfshirjes së dhuratave nga autorë dhe pedagogë të fushës; - Kërkimit aktiv përmes bibliotekave digjitale dhe motorëve akademikë të kërkimit, të aksesueshme nga studentët dhe stafi i Universitetit të Tiranës. Në këtë kontekst, studentët kanë akses të zgjeruar në burime online dhe biblioteka digjitale, përfshirë: - Bibliotekën Digjitale të Universitetit të Tiranës, e cila mbështet kërkimin shkencor dhe konsultimin e literaturës në format elektronik; - Albanian Academic Research Engine, një platformë e integruar për kërkime akademike dhe artikuj shkencorë në gjuhën shqipe dhe të huaj; - JSTOR – Biblioteka digjitale akademike, që ofron mundësi për përmirësimin e kurrikulave, akses në botime shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare; - Rosetta Stone, si një mjet ndihmës për të mësuar gjuhë të huaja, i cili mbështet studentët në përvetësimin e literaturës shkencore ndërkombëtare; - Biblioteka Virtuale e Shqipërisë, që përmbledh koleksione të dijes kombëtare në format digjital.

	<i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHF</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni i arsimit të lartë garanton aksesin e plotë dhe të barabartë për të gjithë studentët e programit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” në bibliotekën mësimore, e cila funksionon si një burim thelbësor për zhvillimin e procesit mësimor, formimin akademik dhe mbështetjen e studimeve individuale. Biblioteka e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë është e hapur për të gjithë studentët, pavarësisht formës së ndjekjes së studimeve (me apo pa shkëputje) dhe ofron akses të barabartë në literaturë, mjete kërkimi dhe hapësira studimi. Në mënyrë të veçantë, për studentët e gazetarisë dhe komunikimit, janë të disponueshme fondet në fushat përkatëse, përfshirë gazetarinë, komunikimin, mediat, politikën, sociologjinë dhe teknologjinë e informacionit. Biblioteka ka një sallë leximi me mbi 70 vende, e konceptuar për përdorim të përbashkët, ku studentët kanë mundësi të punojnë individualisht apo në grup, të huazojnë materiale dhe të konsultojnë fondet në vend. Aksesueshmëria garantohej përmes skedarëve alfabetikë, sistematikë dhe elektronikë, si dhe me ndihmën e sistemit COBISS.Net, që lejon identifikimin dhe lokalizimin e materialeve në kohë reale. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHF</i> <i>E.3.2. Rregullore e Bibliotekës</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë ka një fond fizik të pasur, të përditësuar dhe të përshtatur me nevojat akademike të programit “Bachelor në Gazetari dhe Komunikim”. Ky fond përmban tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, botime shkencore dhe revista profesionale në gjuhën shqipe dhe të huaja, të cilat mbulojnë të gjitha modulet dhe veprimtaritë mësimore të programit, sipas natyrës dhe specifikës së tij. Fondi i bibliotekës përfshin mbi 51,000 tituj librash dhe rreth 400 tituj periodikësh, të shpërndarë në fusha të ndryshme që lidhen drejtpërdrejt me kurrikulën e programit, si: gazetaria, komunikimi, gjuha dhe letërsia, historia, filozofia, sociologjia, media digjitale, ligji për median dhe kultura bashkëkohore. Studentët dhe pedagogët kanë akses të drejtpërdrejtë në këto materiale përmes sallës së leximit me fonde të hapura dhe huazimit për përdorim afatshkurtër ose afatgjatë. Literatura është e përzgjedhur dhe e përditësuar nga pedagogët e fushës, të cilët në bashkëpunim me strukturat drejtuese të departamentit dhe bibliotekës sigurojnë që titujt të jenë në përputhje me zhvillimet më të fundit akademike dhe kërkesat e moduleve të veçanta. Botimet përfshijnë si vepra themelore të




	autorëve klasikë të fushës, ashtu edhe manuale, studime bashkëkohore dhe përmbledhje artikujsh shkencorë. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHF</i> <i>E.3.2. Rregullore e Bibliotekës</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni i arsimit të lartë, në funksion të mbështetjes së programit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”, garanton akses të barabartë dhe pa pagesë për të gjithë studentët në bibliotekat online dhe burimet digjitale, të cilat mbulojnë në mënyrë të plotë fushat përkatëse të gazetarisë, komunikimit, medias dhe shkencave sociale. Studentët kanë në dispozicion Bibliotekën Digjitale të Universitetit të Tiranës, që ofron materiale akademike dhe kërkimore të përditësuara në gjuhën shqipe dhe të huaj, të aksesueshme në çdo kohë përmes lidhjes institucionale. Po ashtu, përdoruesit përfitojnë shërbim pa pagesë në një sërë platformash dhe katalogësh elektronikë të përmendura në kriterin 2. Përdorimi i këtyre burimeve digjitale nuk ka kosto për studentët dhe përbën një pjesë integrale të procesit të mësimnxënies dhe të përgatitjes akademike, duke u ofruar atyre mundësi të barabarta për të ndjekur zhvillimet më të fundit në fushën e studimit. Për më tepër, informacioni mbi këto platforma dhe mënyra e përdorimit të tyre u komunikohet studentëve në fillim të vitit akademik dhe përforcohet gjatë procesit të orientimit akademik dhe seminareve praktike të zhvilluara nga stafi pedagogjik dhe biblioteka. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHF</i> <i>E.3.2. Rregullore e Bibliotekës</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë është e pajisur me programe kompjuterike funksionale dhe pajisje teknike të nevojshme, që mundësojnë akses të lirë, të barabartë dhe pa kufizim për të gjithë studentët. Biblioteka disponon pajisje kompjuterike të dedikuara për kërkim bibliografik, konsultim të katalogut elektronik dhe përdorim të burimeve digjitale të njohura. Këto mjete digjitale i shërbejnë studentëve për kërkime akademike, konsultim të literaturës, përgatitje të projekteve dhe eseve, si dhe për ndjekjen e moduleve që kërkojnë referenca ndërdisiplinare dhe shumëgjuhëshe. Pajisjet janë të vendosura në hapësirat e bibliotekës dhe janë të përdorshme gjatë orarit të saj zyrtar, pa kufizim për kategori përdoruesish. Gjithashtu, rrjeti Wi-Fi dhe sistemi i ndriçimit, ajrosjes dhe ngrohjes, i përmirësuar pas rikonstruksionit të vitit 2014, garanton një mjedis të përshtatshëm teknologjikisht për punë individuale dhe kolektive. Këto kushte e bëjnë bibliotekën një mjedis të aksesueshëm, funksional dhe të përfshirë në procesin bashkëkohor të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

	Pra, institucioni përmbush në mënyrë të plotë këtë kriter, duke garantuar infrastrukturë teknike dhe teknologjike për të gjithë studentët e programit. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHF</i> <i>E.3.2. Rregullore e Bibliotekës</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Institucioni i arsimit të lartë siguron që biblioteka e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të funksionojë në përputhje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, duke iu përgjigjur nevojave reale të studentëve të programit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”. Biblioteka është e aksesueshme nga të gjithë studentët, përfshirë ata që ndjekin studimet me dhe pa shkëputje nga puna, dhe ofron kapacitete të përshtatshme, si salla e leximit me mbi 70 vende, që mbështet punën individuale dhe atë në grup. Orari i funksionimit është i përditësuar dhe i komunikueshëm për studentët, ndërsa hapësirat dhe shërbimet janë të organizuara në mënyrë që të mundësojnë akses të drejtë dhe të barabartë në fondin bibliotekar, duke përmbushur në mënyrë të plotë kërkesat e këtij kriteri. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHF</i> <i>E.3.2. Rregullore e Bibliotekës</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Në përputhje me Nenin 17 të Rregullores së Bibliotekës, stafi i bibliotekës është përgjegjës për krijimin dhe përditësimin e listës së literaturës për pasurimin e fondit, bazuar në kërkesat e përdoruesve. Biblioteka monitoron dhe raporton rregullisht për cilësinë, përditësimin dhe shfrytëzimin e fondit fizik dhe atij online, përfshirë përdorimin e sallave të studimit dhe platformave digjitale (UT, COBISS.Net, JSTOR, etj.). Pasurimi i fondeve realizohet përmes blerjeve të planifikuara, dhuratave dhe bashkëpunimit me stafin akademik për përzgjedhjen e titujve të rinj. Të dhënat mbi shfrytëzimin dhe nevojat për literaturë pasqyrohen në raportet vjetore të bibliotekës, duke siguruar përmirësim të vazhdueshëm dhe përputhje me standardet e arsimit të lartë. Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit bashkëpunon me bibliotekën e fakultetit në mënyrë të vazhdueshme mbi cilësinë dhe përditësimin e fondit fizik dhe digjital, përmes analizës së titujve bazë dhe ndihmës në përputhje me lëndët që mbulohen në programin e studimit ku evidentohen nevojat për zgjerim të literaturës sipas moduleve dhe vlerësimi i angazhimit të stafit akademik në përditësimin e materialeve dhe orientimin e studentëve në përdorimin e burimeve. <i>E.3.2. Rregullore e Bibliotekës</i>

	<i>Informacion i marrë nga vizita në institucion 08 prill 2025</i>			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se programi i studimit siguron literaturë të nevojshme dhe të përditësuar për mbështetjen e mësimdhënies, duke u bazuar në një fond adekuat fizik dhe digjital. Biblioteka dhe mjediset mbështetëse janë të organizuara dhe të aksesueshme për studentët dhe personelin akademik, duke kontribuar në një mjedis efektiv të mësimnxënies. Në veçanti, vlerësohet bashkëpunimi i mirë midis stafit akademik dhe bibliotekës në përzgjedhjen dhe pasurimin e literaturës, si dhe përdorimi i platformave digjitale që zgjerojnë aksesin në burime të ndryshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Programi i studimit “Gazetari dhe Komunikim” funksionon në kuadër të sistemit të menaxhimit institucional të Universitetit të Tiranës, i cili garanton administrimin e plotë dhe të integruar të informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre akademik nga regjistrimi deri në diplomim. Universiteti i Tiranës përdor platformën Microsoft Office 365 Education, e cila përfshin aplikacionin Microsoft Teams, si një hapësirë bashkëpunuese digjitale për procesin mësimor. Përmes kësaj platforme, profesorët krijojnë grupe për çdo lëndë, duke i mundësuar studentëve të programit të komunikojnë në mënyrë efektive me pedagogët dhe kolegët, të ndajnë materiale mësimore, të marrin detyra dhe të ndjekin sesione online përmes funksioneve si chat, audio/video call dhe ndarja e dokumenteve. Paralelisht, sistemi elektronik “e-Student” siguron menaxhimin administrativ të të dhënave studentore. Në këtë sistem, i cili është funksional dhe i aksesueshëm për të gjithë studentët përmes kredencialeve të e-Albania, studentët mund të kryejnë veprime si: regjistrimi në provime, ndjekja e notave dhe historikut akademik, dorëzimi i kërkesave për përmirësim ose ankimim të notave, si dhe verifikimi i të dhënave financiare për tarifat e studimit.
	<i>E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score</i> <i>E.2.10. Manual përdorimi i sistemit e-Student</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë	Administrimi i informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ që

informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	kontribuon në realizimin e programit “Gazetari dhe Komunikim” realizohet nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të Universitetit të Tiranës. Në nivel institucional, Universiteti përdor sisteme të brendshme të dokumentimit dhe arkivimit, të cilat garantojnë menaxhimin e të dhënave për stafin, përfshirë ngarkesën mësimore, oraret, dokumentacionin mbi kualifikimet, raportet vjetore, vlerësimet e performancës dhe angazhimet kërkimore-shkencore. Këto të dhëna përpunohen dhe përditësohen nga sekretaria mësimore në bashkëpunim me strukturat drejtuese të fakultetit dhe njësinë bazë. Gjithashtu, përdorimi i Microsoft Teams dhe Office 365 lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin e brendshëm mes stafit akademik dhe administrativ, si dhe koordinimin e veprimtarive mësimore e mbështetëse. Angazhimi i partnerëve të jashtëm në programin e studimit (si profesionistë të medias ose ekspertë të fushës) dokumentohet dhe menaxhohet përmes marrëveshjeve kontraktuale dhe evidentohet në planet mësimore e raportet e aktivitetit vjetor. Regjistrat fizikë të lëndëve dhe procesverbalet e provimeve administrohen nga Sekretaria Mësimore e njësisë bazë. <i>E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score</i> <i>E.2.10. Manual përdorimi i sistemit e-Student</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.4.3. Rregulla të sekretarisë mësimore</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se përmes përdorimit të platformës e-Student për studentët dhe sistemeve të brendshme administrative për personelin, sigurohet një nivel i kënaqshëm aksesimi në dokumentacion dhe informacione akademike. Studentët mund të konsultojnë të dhënat personale, regjistrimet në lëndë dhe provime, rezultatet dhe pagesat, ndërsa personeli ka qasje në dokumentet e ngarkesës mësimore, planet mësimore, dhe njoftimet institucionale. <i>E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score</i> <i>E.2.10. Manual përdorimi i sistemit e-Student</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Platforma Microsoft Teams, e integruar në paketën Microsoft 365 Education të Universitetit të Tiranës, është një mjet efektiv për komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet studentëve dhe pedagogëve. Teams mundëson zhvillimin e mësimin në distancë, ndarjen e materialeve, publikimin e njoftimeve, diskutime në kohë reale, si dhe koordinimin e punës në grupe. Funksionet e chat-it, audio/video call-it dhe ndarjes së dokumenteve e bëjnë këtë platformë të përshtatshme për nevojat e programit të studimit në Gazetari dhe Komunikim.



	E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të veprimtarive kryesore akademike dhe administrative, përmes platformave të brendshme dhe strukturave të njësive përkatëse. Të dhënat mbi regjistrimet, provimet, ngarkesat mësimore dhe aktivitetet pedagogjike përpunohen dhe raportohen rregullisht për organet drejtuese, duke garantuar vendimmarrje të bazuar në informacion dhe ndjekje të vazhdueshme të standardeve të cilësisë.	E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit siguron informacion të plotë dhe të përditësuar për programet akademike, stafin dhe aktivitetet në faqen zyrtare online të fakultetit në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Për shembull, seksioni “Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit” në faqen zyrtare të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë ofron të dhëna mbi programin Bachelor dhe programet Master në shqip e anglisht, duke përfshirë listën e stafit akademik me profile specifike (Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë). Në faqen online të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë publikohen planet mësimore të semestrave të programit të studimit (p.sh., lëndët për secilin vit studimi), si dhe njoftime për aktivitete të studentëve dhe projekte ndërkombëtare (p.sh., Erasmus+). Duke ofruar informacion paralel në anglisht, institucioni lehtëson aksesin për: - Studentë dhe stafe nga jashtë vendit (Erasmus+); - Partnerë akademikë ndërkombëtarë dhe pjesëmarrës në projekte të financuara nga BE ose institucione të tjera. <i>Evidenca faqja online e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë</i> https://fhf.edu.al/
Konkluzione	GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht. Universiteti i Tiranës ka në përdorim një sistem të brendshëm menaxhimi që mbështet administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ për programin e studimit "Gazetari dhe Komunikim". Sistemi përfshin platforma funksionale si e-Student për administrimin e të dhënave të studentëve dhe Microsoft Teams për komunikimin dhe procesin mësimor. Po ashtu, përdorimi i sistemeve të dedikuara për stafin akademik dhe administrativ, si dhe integrimi me portalin qeveritar e-Albania, siguron akses të strukturuar dhe të centralizuar në informacionet relevante.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se zbatohet një planifikim buxhetor i strukturuar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, Statutin dhe rregulloret e brendshme të institucionit. Planifikimi financiar përfshin të gjithë institucionin dhe realizohet në disa faza, duke filluar nga propozimet e njësive bazë (departamenteve dhe fakulteteve) deri në miratimin përfundimtar nga Bordi i Administrimit, me afat të rregullt vjetor. Megjithatë buxheti nuk realizohet në nivel programi studimi, kjo ndodh për arsye funksionale dhe organizative, pasi pedagogët janë të angazhuar njëkohësisht në disa programe, ndërsa shpenzimet materiale dhe logjistike mbulohen në mënyrë të përbashkët për të gjithë njësinë përkatëse (fakultetin apo departamentin). Nëpërmjet procesit të konsoliduar të buxhetimit për të gjithë fakultetin, sigurohet një mbështetje e qëndrueshme financiare edhe për programin "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim". Planifikimi përfshin pagesat e personelit akademik dhe ndihmës, mirëmbajtjen e infrastrukturës, pasurimin e literaturës, shpenzimet për laboratorë, teknologji dhe aktivitetet mësimore-praktike, duke garantuar realizimin normal të programit gjatë gjithë ciklit trevjeçar të studimeve. Në procesin e hartimit të planeve financiare dhe buxhetimit, zbatohen me përpikmëri dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi, rregullat e administrimit tatimor, si dhe parashikimet e Statutit dhe të rregulloreve të brendshme të Universitetit. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.4.4. Raporti financiar dhe kostoja e programit</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe	Plani i financimit hartohet në nivel institucional dhe përfshin të gjithë zërat e nevojshëm për funksionimin e qëndrueshëm të universitetit dhe mbarëvajtjen e të gjitha programeve të studimit në njësitë përbërëse të tij. Struktura financiare përfshin: - Të ardhurat, që burojnë nga tarifat studentore, fondet e projekteve dhe burime të tjera të ligjshme; - Shpenzimet, që mbulojnë mësimdhënien dhe administrimin akademik, aktivitetet kërkimore-shkencore, projektet e

E-mail: info@ascal.al

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit "Qemal Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43-123

Web site: www.ascal.al

teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	kërkimit, shpenzimet administrative të përgjithshme, si dhe investimet në infrastrukturë dhe teknologji në shërbim të të gjitha programeve të studimit. Bordi i Administrimit, si organi më i lartë administrativ i Universitetit të Tiranës, miraton dhe mbikëqyr zbatimin e buxhetit institucional, duke garantuar mbarëvajtjen financiare dhe përmbushjen e objektivave strategjike të institucionit. Zyra e Financës kryen përllogaritjet e të ardhurave dhe shpenzimeve, analizon treguesit financiarë dhe harton raporte periodike për Bordit e Administrimit, të cilat shërbejnë për vendimmarrje të bazuar dhe prioritizim të investimeve në nivel fakulteti dhe departamenti. Edhe pse buxheti nuk realizohet në nivel programi të veçantë studimi, programi “Bachelor në Gazetari dhe Komunikim” përfiton nga buxheti i njësisë bazë, i cili mbulon: - Financimin e burimeve njerëzore, përfshirë personelin akademik dhe ndihmës-akademik; - Shpenzimet operative për funksionimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të mësimdhënies, laboratorëve të gazetarisë dhe teknologjive mbështetëse; - Shpenzimet për pasurimin e bibliotekës, përfshirë blerjen e literaturës dhe aksesin në biblioteka digjitale; - Detyrimet administrative dhe financiare që lidhen me menaxhimin e programit; - Grantet e përfituara nga projekte të bashkëfinancuara me aktorë vendas dhe ndërkombëtarë, që kanë kontribuar në zhvillimin e kërkimit dhe formimit praktik të studentëve; - Kontratat e shërbimeve dhe bashkëpunimet me institucione mediatike, për praktika profesionale, projekte studimore dhe mbështetje logjistike të procesit akademik. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.4.4. Raporti financiar dhe kostoja e programit</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Universiteti i Tiranës në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregulloret për administrimin financiar publik, zbaton mekanizma të rregullt për auditim të brendshëm dhe të jashtëm financiar, me qëllim monitorimin dhe garantimin e efektivitetit të përdorimit të burimeve ekonomike. Auditimi realizohet në mënyrë periodike nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, e ngritur në nivel institucional, e cila kontrollon dokumentacionin financiar, vlerëson përputhshmërinë me procedurat ligjore dhe monitoron përdorimin racional të fondeve. Gjithashtu, Zyra e Financës harton dhe ruan dokumentacionin e nevojshëm për të gjitha operacionet financiare, duke përfshirë përllogaritjet e të ardhurave dhe shpenzimeve, analizën e treguesve financiarë, raportet vjetore dhe informacionin mbi zbatimin e buxhetit sipas njësive bazë. Këto auditime dhe vlerësime shërbejnë për garancinë e transparencës dhe llogaridhënies, përmirësimin e planifikimit financiar në nivel



	njësish akademike dhe administrative, vendimmarrje të bazuar në evidencë për prioritizimin e investimeve dhe burimeve, duke përfshirë edhe mbështetjen për programet e studimit si Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim". Praktikat e auditimit dhe vlerësimit të gjendjes financiare konsiderohen nga GJV si një element thelbësor që kontribuon në qëndrueshmërinë institucionale dhe cilësinë e menaxhimit financiar në funksion të objektivave akademike. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.4.4. Raporti financiar dhe kostoja e programit</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në përputhje me rregullat financiare dhe statutin e Universitetit të Tiranës, kryhen raportime në mënyrë të rregullt dhe të strukturuar mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës, duke e detajuar informacionin deri në nivel të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Pas mbylljes së vitit financiar, Zyra e Financës, në bashkëpunim me njësitet bazë harton raporte për analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat reflektojnë ecurinë e përdorimit të fondeve. Këto raporte i përcillen strukturave përkatëse drejtuese të fakultetit dhe departamenteve (njësive bazë), për të garantuar transparencë, përgjegjshmëri dhe planifikim të informuar për vitin pasardhës. Raportet e realizimit të buxhetit shërbejnë gjithashtu si bazë për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe për prioritizimin e nevojave të secilës njësi në raport me objektivat strategjike të institucionit. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.4.4. Raporti financiar dhe kostoja e programit</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Universiteti i Tiranës garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e të gjitha programeve të studimit në njësitë bazë, përfshirë programin Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim", nëpërmjet një strukture të konsoliduar planifikimi dhe menaxhimi financiar, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore përkatëse. Buxheti institucional siguron mbulim të vazhdueshëm të nevojave për: - Financimin e burimeve njerëzore akademike dhe ndihmës akademike; - Shpenzimet infrastrukturore dhe operative për funksionimin normal të departamentit dhe fakultetit; - Mbështetjen e aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe praktike, përfshirë investimet në laboratorë, pajisje teknologjike dhe pasurimin e literaturës. Universiteti ndjek një politikë të diversifikimit të burimeve të financimit, përmes: - Projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare; - Granteve të ofruara nga partnerë institucionalë dhe organizata ndërkombëtare;

	- Marrëveshjeve të bashkëpunimit me aktorë të sektorit mediatik dhe civil, të cilat përfshijnë mbështetje për praktikat profesionale, projekte studimore dhe trajnime të studentëve. E.1.1. Statuti i UT-së E.4.4. Raporti financiar dhe kostoja e programit			
Konkluzione	Nga analiza e dokumentacionit dhe informacionit të mbledhur gjatë procesit të vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se Universiteti i Tiranës garanton në mënyrë të qëndrueshme mbështetjen financiare të nevojshme për zhvillimin e programit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim", në përputhje me kërkesat e standardit IV.5. Financimi institucional mbulon të gjitha aspektet thelbësore të programit, duke reflektuar një model funksional dhe të qëndrueshëm të financimit në shërbim të arsimit cilësor dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Zbatohen politika dhe procedura të qarta dhe të dokumentuara që mbulojnë gjithë ciklin akademik të studentëve, nga momenti i hyrjes në programin e studimit deri në diplomim. Këto politika dhe procedura janë në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar në fuqi, si dhe me aktet rregullatore të universitetit. Elementet kryesore të realizimit të këtij kriteri përfshijnë: - Procesi i regjistrimit dhe pranimit. Institucioni ka përcaktuar kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve në programin bachelor "Gazetari dhe Komunikim" duke respektuar kuotat dhe rregullat ligjore, si dhe duke siguruar transparencë në procesin e përzgjedhjes. - Menaxhimi i procesit mësimor. Politikat dhe procedurat përfshijnë zhvillimin e planprogramit, orarin e mësimit, mënyrën e vlerësimit dhe monitorimit të studentëve gjatë

E-mail: info@ascal.al

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjimnazit "Qemal Stafa", Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

	gjithë ciklit, duke garantuar standarde të njëjta për të gjithë studentët. - Regjistrimi dhe administrimi i provimeve. Ekzistojnë rregulla të përcaktuara për regjistrimin në provime, mënyrën e zhvillimit të tyre, si dhe procedurat për ankesa dhe përmirësime të notave. - Mbështetja dhe këshillimi akademik. Institucioni ka vendosur mekanizma për ndjekjen dhe mbështetjen e studentëve gjatë studimeve, duke përfshirë këshillimin akademik dhe orientimin karrierës. - Diplomimi dhe certifikimi. Procedurat për përfundimin e studimeve, vlerësimin përfundimtar dhe dhënien e diplomës janë të rregulluara dhe të harmonizuara me ligjet për arsimin e lartë. Politikat dhe procedurat janë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe me rregulloret e brendshme të Universitetit të Tiranës, duke siguruar zbatim të standardeve të cilësisë. <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E.4.3. Rregulla të Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura të qarta që garantojnë barazinë dhe trajtim të drejtë për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit, në të gjitha fazat e ciklit akademik, nga hyrja deri në dalje. Këto politika janë në përputhje me ligjet kombëtare për arsimin e lartë dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e studentëve, duke përfshirë parimin e mosdiskriminimit në bazë të gjinisë, etnisë, besimit, statusit social apo aftësive të ndryshme. Elementet kyçe të realizimit përfshijnë procedura të hapura dhe transparente të pranimit, të cilat janë të bazuara në kritere objektive dhe të njëjta për të gjithë kandidatët, pa asnjë formë favorizimi apo diskriminimi. Trajtim i barabartë gjatë gjithë kohës së studimeve, duke siguruar qasje të njëjtë në burimet akademike, mbështetje për studentët me nevoja të veçanta, si dhe të drejtën për ankesa dhe shqyrtim të vendimeve në mënyrë të drejtë dhe transparente. Politika të qarta për trajtimin e ankesave dhe konflikteve, që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të studentëve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë objektive dhe të paanshme. Aktet rregullatore të Universitetit të Tiranës, njësisë kryesore dhe asaj bazë garantojnë barazinë dhe të drejtat e njëjta për të gjithë studentët e programit të studimit. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i>

	E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim" E.5.4. Kriteret dhe kuotat e pranimit
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", konkretisht me nenin 74, hartohen dhe publikohen çdo vit kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve. Për programin Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim", pranimi i studentëve realizohet nëpërmjet platformës qendrore të aplikimeve për maturantët, në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe në përputhje me vendimet vjetore të Këshillit të Ministrave për pragun minimal të mesatares së pranimit. Kriteret janë gjithashtu të publikuara në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës. Sipas Nenit 42 të Rregullores së Programit të Studimit, çdo kandidat që ka përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe plotëson kriterin e mesatares mund të aplikojë për regjistrim. Rregullorja e programit të studimit parashikon që Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit mund të propozojë kriteret shtesë nëse e konsideron të nevojshme, të cilat shpallen publikisht dhe përcillen në institucionet përkatëse. Studentët, gjatë procesit të regjistrimit, njihen me përmbajtjen dhe natyrën e programit të studimit, me objektivat formues dhe strukturën mësimore. Përveç aplikimit online, kandidatët dorëzojnë dokumentacionin zyrtar të pranimit, siç përcaktohet në Nenin 43 të Rregullores, që përfshin: diplomën dhe dëftesën e notave të shkollës së mesme, certifikatën e lindjes, kërkesë me shkrim, letër motivimi, CV dhe mandat pagese për taksën e regjistrimit. Gjithashtu, institucioni parashikon mundësi pranimi edhe për studentë të huaj, më së shumti nga trojet. E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim" E.5.4. Kriteret dhe kuotat e pranimit <i>Evidenca faqja online e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë</i> https://unitir.edu.al/arkiva-2024-2025-kriteret-e-pranimit-ne-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-ne-universitetin-e-tiranes/ https://fhf.edu.al/kriteret-e-pranimit-ne-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-ne-universitetin-e-tiranes-per-vitin-akademik-2023-2024/
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve	Kriteret, rregullat dhe procedurat që lidhen me pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, transferimit dhe diplomimin e studentëve janë të qarta, transparente dhe lehtësisht të aksesueshme nga publiku. Këto procedura janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës, Rregulloren e Programit të Studimit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim", dokumentacionin shoqërues të shpërndarë gjatë

dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	aplikimit dhe regjistrimit, si dhe në faqen zyrtare të UT-së dhe të njësisë kryesore. I gjithë informacioni është i aksesueshëm në gjuhë të kuptueshme për studentët dhe publikun e gjerë, të afishuara në mënyrë të rregullt në format fizik (në ambientet e fakultetit dhe departamentit) dhe në mënyrë digjitale në portalet zyrtare të UT-së dhe fakultetit. Për më tepër, në fillim të vitit akademik organizohen sesione informuese për studentët e rinj, ku ofrohet orientim mbi të drejtat, detyrimet, strukturën e programit dhe procedurat administrative. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E.5.4. Kriteret dhe kuotat e pranimi</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit informon në kohë dhe në mënyrë të aksesueshme publikun dhe aktorë të interesuar mbi kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që lidhen me pranimin në programin Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim". Kjo realizohet në disa mënyra të koordinuara: - Publikimi zyrtar i kriterëve të pranimi dhe informacioneve mbi programin në faqen e Universitetit të Tiranës, të fakultetit dhe të vetë departamentit, në përputhje me udhëzimet vjetore të MAS dhe rregulloret institucionale; - Zbatimi i një plani të dedikuar marketingu, i cili synon të rrisë dukshmërinë e programit dhe të ofrojë informacion të qartë, të strukturuar dhe të personalizuar për studentët e ardhshëm. Plani i marketingut i hartuar dhe zbatuar nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, përfshin: - Strategji të komunikimit digjital dhe tradicional; - Organizimin e sesioneve informuese dhe ditëve të hapura, në bashkëpunim me shkollat e mesme dhe aktorë të sektorit të medias; - Promovimin e cilësisë së programit, mundësive për praktikë profesionale dhe historive të suksesit të alumnive, për të nxitur interes të qëndrueshëm dhe të informuar; - Shtrirje të synuar në rrjetet sociale dhe platformat interaktive, duke përfshirë maturantët, studentët potencialë dhe prindërit. Për më tepër, të gjitha informacionet mbi strukturën e programit, profilin profesional, kriteret e pranimi, dokumentacionin e nevojshëm dhe procedurat e regjistrimit ofrohen në mënyrë të qartë dhe të përditësuar çdo vit, përpara fillimit të afateve zyrtare të aplikimeve dhe regjistrimeve. <i>E.5.5. Politika e marketingut për programin e studimit</i>




	<i>E.5.2. Udhërrëfytyesi i programeve të studimit</i> <i>E.5.3.b. Udhërrëfytyesi i programeve të studimit FHF</i> <i>E. 5.3 A Udhëzuesi i programeve të studimit në DGK</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar për arsimin e lartë, si dhe me aktet nënligjore dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, respektohen dhe zbatohen kriteret për pranimin e kandidatëve nga kategori të veçanta, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, nga kategoritë të pakicave dhe shtresa të marginalizuara. Kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta hartohen dhe zbatohen në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, ku parashikohet mundësia e kuotave të veçanta për këto kategori. Rregulloret dhe praktikat institucionale sigurojnë respektimin e parimeve të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.1.3. Rregulloret e UT-së</i> <i>E.5.8. Bursa dhe politika mbështetëse për studentët</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Programi i studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” ofrohet në gjuhën shqipe, e cila nënkupton se pjesa më e madhe e kandidatëve ndërkombëtarë vijnë nga trojet shqiptare, ku njohja e gjuhës së programit është e natyrshme dhe nuk kërkon trajtim të veçantë gjuhësor. Kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve nga shtete të tjera përcaktohen në përputhje me rregulloret institucionale të Universitetit të Tiranës dhe aktet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dhe bëhen publike përpara fillimit të çdo viti akademik, përmes kanaleve zyrtare të institucionit. <i>E.1.6. Rregulloret e Programit të Studimit Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”</i> <i>E.5.4. Kriteret dhe kuotat e pranimit</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Çdo fillim viti akademik, në faqen online të njësisë kryesore, publikohen politikat e ndihmës ekonomike për studentët e ciklit të parë, të cilat përfshijnë bursa dhe lehtësira tarifore për shtresat në nevojë. Aplikimi për bursë ose përjashtim tarifash realizohet përmes platformës Microsoft Teams dhe më pas konfirmohet me dorëzimin fizik të dokumentacionit në ambientet e fakultetit, brenda afatit të përcaktuar. Ky proces zhvillohet në përputhje me VKM nr. 39 dhe VKM nr. 40 datë 23.01.2019 dhe përfshin verifikimin e dokumentacionit nga struktura përgjegjëse e FHF-së dhe miratimin përfundimtar nga Bordi i Administrimit të UT-së. Rezultatet publikohen në mënyrë transparente në faqet zyrtare të institucionit dhe platformën elektronike të studentëve. <i>Evidenca faqja online e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë</i>

E-mail: info@ascal.al

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjimnazit “Qemal Stafa”, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

	https://fhf.edu.al/njoftim-aplikimi-per-bursa-dhe-reduktim-tarife-viti-2024-2025/			
Konkluzione	GVJ vlerëson se IAL-ja ka hartuar dhe zbaton në mënyrë të rregullt politika dhe procedura të qarta për pranimin, përzgjedhjen, përparimin dhe diplomimin e studentëve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Këto procedura janë të dokumentuara në rregulloret institucionale dhe të njësisë bazë, të aksesueshme për studentët dhe të publikuara përpara çdo viti akademik. Procedurat e transferimit të studimeve, njohjes së krediteve dhe vlerësimit të dijeve janë të rregulluara përmes praktikave administrative dhe mbështeten nga dokumentacioni përkatës dhe rregullat institucionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni i Arsimit të Lartë siguron informacion të plotë, të detajuar dhe të aksesueshëm për studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat që lidhen me përparimin e tyre akademik dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion u ofrohet studentëve përmes mjeteve të ndryshme formale dhe të strukturuar, që garantojnë transparencë dhe orientim të qartë gjatë gjithë ciklit të studimeve. Elementet që dëshmojnë realizimin e këtij kriteri përfshijnë: - Udhërrëfyesi i programeve të studimit, i cili i jep studentëve një pasqyrë të plotë mbi strukturën e programit, ngarkesën mësimore, si dhe ecurinë akademike që kërkohet për çdo vit studimi. - Java e orientimit, e organizuar për studentët e rinj, ofron një prezantim të detajuar të kërkesave akademike, sistemit të krediteve, mënyrës së vlerësimit dhe kriteret për kalimin e vitit akademik. - Rregullorja e Universitetit të Tiranës, në Nenin 63, përcakton qartë numrin minimal të krediteve që një student duhet të përfitojë për të kaluar në vitin pasardhës, duke e bërë këtë informacion të detyrueshëm dhe të zbatueshëm për të gjithë. - Rregullorja specifike e programit të studimit, në Nenin 22 dhe 27, rregullon në mënyrë të hollësishme procedurat që lidhen me përparimin akademik, duke paraqitur në mënyrë të qartë strukturën, organizimin dhe funksionimin akademik të programit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Qemal Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E.5.2. Udhërrëfyesi i programeve të studimit</i> <i>E. 5.3 A Udhëzuesi i programeve të studimit në DGK</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në përputhje me legjislacionin aktual, udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe parimet e Kartës së Bolonjës, Universiteti i Tiranës ofron mundësinë e transferimit të studentëve në vitet ndërmjetëse, nga institucionet publike ose jopublike të arsimit të lartë. Kjo praktikë rregullohet në përputhje me Udhëzimin Nr. 32, datë 30.07.2019, që përmban ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr. 10, datë 15.05.2019, për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, si dhe Nenin 79 të Rregullores së Universitetit të Tiranës për njohjen dhe njësimin e periudhave të studimit. Bazuar në këto akte: - UT lejon njohjen dhe transferimin e krediteve midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UT-së apo nga institucione të tjera të arsimit të lartë kombëtare dhe ndërkombëtare. - Kreditet dhe periudhat e studimit të përfunduara në institucione të tjera njihen dhe njësohen me ato të programit përkatës në UT, sipas kriterëve dhe rregulloreve të brendshme. - Njësimi i krediteve dhe përcaktimi i detyrimeve akademike të mbetura bëhet nga komisioni përkatës në njësinë akademike ku studenti paraqet kërkesën. - Komisioni përcakton edhe vitin akademik në të cilin studentit duhet të vazhdojë studimet pas transferimit. - Në Supplementin e Diplomës dokumentohen të dhënat përkatëse të transferimit, duke përfshirë numrin e mëparshëm të matrikulimit, vitin e fillimit të studimeve në institucionin origjinal dhe kreditet e njohura nga UT.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> Syllabuset e lëndëve, sipas dokumentacionit institucional, përcaktojnë qartë metodat, kriteret dhe procedurat e vlerësimit për çdo program studimi. Këto kriteret janë gjithashtu të përfshira në rregulloren mësimore të programit Bachelor GK. Pedagogët prezantojnë këto kriteret në fillim të çdo viti akademik, për t'u siguruar që studentët të jenë të informuar qartë dhe në mënyrë transparente mbi mënyrën e vlerësimit. Gjithashtu, studentët informohen edhe nëpërmjet sistemit Teams. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i>

	<i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Informacioni për kriteret e punimit të diplomës (si tema, formati, metodat e kërkimit, kriteret e vlerësimit) dhe procedurat e diplomimit (afatet, dokumentet e nevojshme, procesi i dorëzimit, mbrojtja e punimit) bëhet i disponueshëm për studentët përmes materialeve udhëzuese për studentët. Gjatë periudhës së përgatitjes së diplomës organizohen takime informuese që synojnë të njohin studentët me kërkesat akademike dhe administrative për punimin e diplomës. Studentët asistohen nga pedagogë udhëheqës, të cilët ofrojnë asistencë gjatë zgjedhjes së temës, zhvillimit të punimit dhe përgatitjes për mbrojtjen e diplomës. <i>E.3.3. Material udhëzues për punimin e diplomës, Ba</i> <i>E.3.4. Skedë vlerësimi për temën e diplomës në Ba</i> <i>E. 3.5. Format i diplomës dhe suplementi</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni i arsimit të lartë përmbush kriterin duke publikuar përpara fillimit të çdo viti akademik një udhëzues të detajuar të programit të studimit, i cili është gjithashtu i disponueshëm online për akses të lehtë nga studentët dhe të interesuarit. Gjithashtu, organizohet java orientuese dhe takime të hapura informuese, ku studentët e ardhshëm njihen me strukturën, kërkesat dhe procedurat e programit, duke u siguruar një orientim të qartë dhe të plotë për fillimin e studimeve. Ky proces ndihmon në integrimin dhe përgatitjen e studentëve në mënyrë efikase në ambientin akademik. <i>E.5.2. Udhërrëfyesi i programeve të studimit</i> <i>E. 5.3 A Udhëzuesi i programeve të studimit në DGK</i>			
Konkluzione	Grupi i vlerësimit vlerëson se UT përmbudh plotësisht standardin, duke siguruar informacion të plotë dhe të detajuar për studentët lidhur me përparimin akademik, njohjen dhe vlerësimin e dijeve gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe deri në diplomim. Procedurat e aplikuara janë të aksesueshme për studentët, duke ndihmuar në ndjekjen e statusit akademik dhe lehtësimin e komunikimit midis studentëve dhe stafit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjimnazit «Qemal Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Institucioni i arsimit të lartë siguron informim të hollësishëm dhe të qartë për studentët lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit përmes disa dokumenteve dhe materialeve zyrtare. Rregullorja e programit të studimit përmban dispozitat ligjore dhe rregullat që qartësojnë të gjitha aspektet akademike dhe administrative të programit. Udhëzuesi i programit të studimit ofron informacion të detajuar mbi përmbajtjen e lëndëve, kurrikulën, mënyrën e organizimit të procesit mësimor dhe kërkesat për përfundimin e studimeve. Planet mësimore për çdo semestër dhe kreditet akademike (ECTS) janë të publikuara dhe të aksesueshme për studentët, duke u mundësuar atyre të ndjekin në mënyrë të qartë rrjedhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, si dhe të planifikojnë në mënyrë efektive përparimin e tyre akademik. Ky informacion shpërndahet në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës së studimeve dhe është i disponueshëm në platformën elektronike e-student, si dhe faqen zyrtare online të institucionit. Gjithashtu, koordinatori i programit të studimit asiston studentët për çdo sqarim apo informacion që kërkohet. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E. 5.3 A Udhëzuesi i programeve të studimit në DGK</i> <i>E.2.3. Urdhër për emërimin e koordinatorit të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni i arsimit të lartë siguron informacion të detajuar për çdo lëndë/modul të programit të studimit, duke përfshirë përmbajtjen akademike dhe veprimtaritë formuese. Syllabuset e çdo lënde përmbajnë objektivat mësimore, temat kryesore, metodologjinë e mësimdhënies, kriteret e vlerësimit, si dhe aktivitetet praktike/projektin dhe punën individuale të studentit. Ky material është i aksesueshëm për studentët përmes platformës e-student dhe është i disponueshëm që në fillim të vitit akademik për të lehtësuar planifikimin dhe ndjekjen e mësimit. Gjithashtu, stafi akademik mbështet studentët dhe i orienton për realizimin e veprimtarive formuese, duke siguruar një proces mësimor të strukturuar dhe bashkëpunues. Departamenti GK informon në mënyrë të vazhdueshme studentët për aktivitetin dhe veprimtaritë mësimore. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit luan një rol aktiv në orientimin profesional të studentëve dhe përgatitjen e tyre për integrim të suksesshëm në tregun e punës. Përmes një qasjeje të strukturuar dhe bashkëpunimeve të konsoliduara me institucione relevante të sektorit të medias dhe komunikimit, ai siguron një mjedis mbështetës dhe të

	orientuar drejt praktikës profesionale. Një nga nismat më të rëndësishme në këtë drejtim është marrëveshja e bashkëpunimit me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), e cila synon të forcojë ndërveprimin ndërmjet edukimit akademik dhe kërkesave të tregut mediatik në Shqipëri. Kjo marrëveshje u ofron studentëve: - akses në praktika profesionale pranë AMA-s dhe institucioneve të tjera partnere, - pjesëmarrje në trajnime, forume dhe aktivitete të organizuara në bashkëpunim me ekspertë të fushës, - informim mbi zhvillimet më të fundit në politikat mediatike, teknologjitë e reja dhe kërkesat profesionale, - ndërveprim të drejtpërdrejtë me përfaqësues të tregut të punës dhe aktorë të industrisë së medias. Përveç AMA-s, Departamenti ka zhvilluar edhe aktivitete të tjera me media kombëtare dhe rajonale, agjenci komunikimi dhe PR, organizata joqeveritare, si dhe institucione shtetërore që ofrojnë mundësi punësimi dhe praktike për studentët e programeve në gazetari, komunikim dhe marrëdhënie me publikun. Këto bashkëpunime ndihmojnë jo vetëm në rritjen e kapaciteteve profesionale të studentëve, por edhe në krijimin e një ure lidhëse ndërmjet arsimit të lartë dhe nevojave reale të tregut të punës. Në përputhje me këtë mision, Departamenti GK organizon periodikisht ditë karriere, workshop-e profesionale, si dhe këshillime individuale, duke mbështetur studentët në ndërtimin e rrugës së tyre profesionale dhe në zhvillimin e aftësive të tyre për punësim të qëndrueshëm. Përmes këtyre mekanizmave të integruara, institucioni realizon funksionin e tij strategjik në përgatitjen e profesionistëve të rinj, duke bërë procesin e edukimit njëkohësisht akademik dhe praktik, teorik dhe i orientuar drejt tregut. <i>E.1.4. Plani i Zhvillimit të Departamentit të Gazetarisë 2024-2029</i> <i>E.3.9. Listë trajnimesh prej Zyrës së Këshillimit të Karrierës</i> <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i> <i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni siguron akses të vazhdueshëm për studentët lidhur me të gjitha aspektet që lidhen me organizimin e procesit mësimor dhe funksionimin administrativ e logjistik të tij. Përmes bashkëpunimit të integruar informimi dhe komunikimi, i cili përfshin platforma digjitale, njoftime zyrtare, udhëzues akademikë dhe kontakt të drejtpërdrejtë me strukturat përkatëse. Të gjithë studentët kanë akses në informacionin mbi strukturën dhe kalendarin akademik, përfshirë oraret mësimore, afatet e provimeve dhe aktivitetet e ndryshme, programet mësimore dhe syllabuset, të cilat publikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt në platformën e-student, shërbimet logjistike dhe infrastrukturore, si biblioteka, auditorët,

	laboratorët e medias dhe ambientet e tjera mbështetëse, për të cilat ofrohen informacion mbi vendndodhjen, oraret e funksionimit dhe mënyrën e përdorimit. Gjithashtu, sigurohet mbështetje administrative dhe për shërbimet studentore, përfshirë zyra si ajo e sekretarisë mësimore, zyra e karrierës, shërbimi IT me kontaktet përkatëse të personelit dhe procedurat për adresimin e kërkesave. Komunikimi i drejtpërdrejtë me pedagogët dhe stafin administrativ mundësohet edhe përmes sistemit Teams dhe takimeve informuese me koordinatorin e programit të studimit. <i>E. 5.3 A Udhëzuesi i programeve të studimit në DGK</i> <i>E.2.3. Urdhër për emërimin e koordinatorit të programit të studimit</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni ka implementuar sistemin Teams për menaxhimin e brendshëm të informacionit, i cili siguron akses për studentët në lidhje me të gjithë informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit. Ky sistem mundëson qasje të lehtë, të shpejtë dhe të sigurt nga çdo vend dhe në çdo kohë, duke e bërë të mundur edhe studimin në distancë. Përmes platformës elektronike të universitetit, studentët mund të konsultojnë programet e plota të studimit dhe syllabuset e çdo lënde, planifikimet vjetore dhe oraret e mësimi, materialet mbështetëse dhe burimet e tjera akademike, njoftimet dhe ndryshimet që lidhen me organizimin akademik. Sistemi gjithashtu lehtëson ndërveprimin midis studentëve dhe stafit akademik. <i>E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se UT ka krijuar dhe ofron një sistem efektiv dhe të strukturuar për informimin e studentëve në lidhje me programet e studimit. Informacioni i ofruar përfshin në mënyrë të qartë dhe të detajuar objektivat formuese, strukturën dhe organizimin e programit, duke përfshirë modulët, lëndët dhe ndërlidhjen mes tyre, përmbajtjen e detajuar të lëndëve dhe materialeve mësimore, rezultatet e pritshme të të nxënësve, mundësitë e punësimit dhe zhvillimit profesional, të lidhura me profilin akademik dhe tregun e punës. Informacioni është i aksesueshëm për studentët në mënyrë transparente dhe në kohë reale përmes sistemeve digjitale të menaxhimit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Qemal Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.

Sekretaria mësimore është njësi përgjegjëse për grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave lidhur me numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në çdo program studimi. Statistikat përditësohen çdo vit akademik dhe përfshijnë numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë dhe totalin e studentëve aktivë, numrin e studentëve të diplomuar sipas viteve akademike, tregues të ecurisë së regjistrimeve dhe diplomimeve. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për programin e studimit.

Viti akademik	Studentë të regjistruar	Studentë të diplomuar	Nota mesatare hyrëse	Nota mesatare dalëse
2018-2019	120	61	8	7
2019-2020	100	89	8	7
2020-2021	100	79	8.1	7.1
2021-2022	100	103	8	7
2022-2023	81	63	8.2	7
2023-2024	61	69	8.1	7
2024-2025	47		7.8	

E.4.3. Rregulla të sekretarisë mësimore

E.4.8. BA RVB tabelat permbledhese

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Sekretaria Mësimore në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë disponon dhe përditëson në mënyrë sistematike statistikën vjetore për secilin program studimi. Këto të dhëna përfshijnë numrin e studentëve të regjistruar në fillim të çdo viti akademik, numrin e studentëve që diplomohen me sukses brenda afateve të përcaktuara të programit, numrin e studentëve që tërhiqen nga programi me kërkesë personale ose për arsye të tjera të dokumentuara; numrin e studentëve që largohen para përfundimit të programit për shkak të mosplotësimit të kriterëve akademike apo të disiplinës, si dhe numrin e studentëve që nuk përfundojnë me sukses vitin akademik përkatës.

E.4.3. Rregulla të sekretarisë mësimore

E.4.8. BA RVB tabelat permbledhese

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes regjistrave bazë elektronike të cilët përmbajnë informacion të detajuar dhe të përditësuar në kohë reale. Këta regjistra përfshijnë:

- Regjistrin themeltar të studentëve
- Regjistrin e rezultateve akademike të studentëve
- Regjistrin e diplomave

Të dhënat e regjistruara janë të ruajtura në një database, e cila administrohet nga Sekretaria Mësimore. Kjo njësi mbikëqyr aksesin dhe sigurinë e informacionit, duke siguruar që vetëm personat e autorizuar të kenë akses për modifikim dhe verifikim të të dhënave.

	Rekomandohet që sekretaria mësimore të plotësojë rregullisht dhe në mënyrë sistematike regjistrin fizik të rezultateve akademike. <i>E.4.3. Rregulla të sekretarisë mësimore</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni mbështet dhe garanton kontrollin periodik të përvitshëm të njësive përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave të studentëve, nëpërmjet një kuadri të miratuar rregullator dhe procedural. Ky kontroll zbatohet ndaj sekretarive mësimore në të gjitha njësitë kryesore dhe bazë. Procesi i kontrollit kryhet nga struktura të caktuara të institucionit dhe është i dokumentuar përmes raporteve vjetore. <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i> <i>E.4.7. Rregullore e brendshme e punës për organizimin dhe funksionimin e administratës së rektoratit të UT-së</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia bazë ka zhvilluar një qasje sistematike për vlerësimin e profilit të studentëve në hyrje dhe dalje, si dhe për monitorimin e shkallës së punësimit të tyre pas përfundimit të studimeve. Në këtë kuadër, janë hartuar raporte analitike periodike, të cilat shërbejnë si bazë për marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së programit dhe përshtatjen e tij me nevojat reale të tregut të punës. Bazuar në këto analiza, është hartuar Plani i Zhvillimit të Departamentit të Gazetarisë 2024-2029, i cili përcakton objektivat strategjike për rritjen e cilësisë së arsimit, fuqizimin e lidhjes me tregun e punës dhe përmirësimin e indikatorëve të punësueshmërisë. Gjithashtu, është realizuar Analiza e tregut të punës dhe një Studim i dedikuar i tregut me titullin “Media in Fokus”, i cili përfshin: - Të dhëna mbi numrin e të punësuarve që kanë përfunduar studimet pranë Fakultetit të Histori-Filologjisë (FHF), në profilin Gazetari dhe Komunikim; - Vlerësimin e fushave profesionale ku janë integruar ish-studentët; - Identifikimin e tendencave të reja të punësimit në sektorin mediatik dhe të komunikimit. Këto studime janë ndërmarrë me qëllim përshtatjen e ofertës mësimore me kërkesat dinamike të tregut, rishikimin e moduleve, forcimin e praktikave profesionale dhe fuqizimin e bashkëpunimit me median dhe institucionet e fushës së komunikimit. <i>E.1.4. Plani i Zhvillimit të Departamentit të Gazetarisë 2024-2029</i> <i>E.1.11. Analizë e tregut të punës</i> <i>E.1.12. Studimi i tregut - Media in fokus</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se institucioni i arsimit të lartë ka ngritur mekanizma funksionale për mbledhjen, administrimin, përditësimin dhe ruajtjen e

	të dhënave të studentëve, nga momenti i pranimit deri në diplomim. Këto të dhëna administrohen përmes regjistrave zyrtarë të cilët menaxhohen nga sekretariatë mësimore dhe ruhen në baza të dhënash institucionale. Gjithashtu, institucioni ka ndërmarrë iniciativë për gjurmimin e të dhënave pas diplomimit, përfshirë analizat e tregut të punës dhe studime të dedikuara, siç është rasti me projektin "Media in Fokus" dhe raportet e hartuara në kuadër të Planit të Zhvillimit të Departamentit. Këto të dhëna kontribuojnë në përmirësimin e ofertës akademike dhe në përafrimin e saj me nevojat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Institucioni i arsimit të lartë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, siguron përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, duke respektuar parimet e përfaqësimit dhe të transparencës institucionale. Kjo përfshirje është e parashikuar dhe garantuar në Statutin e Universitetit të Tiranës, konkretisht në nenin 125, ku përcaktohet e drejta e studentëve për të qenë të përfaqësuar në organet kolegjiale të njësive kryesore dhe bazë, si dhe në nenin 126, ku përcaktohen format dhe mënyrat e zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre në këto struktura. Po ashtu, Rregullorja e UT-së (Kreu VII) detajon të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve si pjesë e organeve vendimmarrëse dhe këshilluese, përfshirë Senatin Akademik, Këshillin e Fakultetit dhe Këshillin e Departamentit. Në nivel të njësisë bazë, Rregullorja e Programit të Studimit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim", përmes neneve 35 dhe 36, parashikon përfshirjen e përfaqësuesve të studentëve në Këshillat Studentore dhe komisionet që merren me çështje akademike, organizative dhe të cilësisë së programit. Këto dokumente rregullatore përbëjnë një bazë të qëndrueshme për përfaqësimin efektiv të studentëve, duke i njohur ata si aktorë të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes institucionale dhe në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Në praktikë, përfaqësuesit e studentëve marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e strukturave përkatëse, me të drejtë diskutimi dhe votimi për çështjet që lidhen me interesin e përgjithshëm të komunitetit studentor.

	<i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E.2.11. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit (Shembull)</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Institucioni i arsimit të lartë garanton një përfshirje reale, konkrete dhe me ndikim të studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në proceset e vendimmarrjes, këshillimit dhe vlerësimit të veprimtarisë akademike, duke respektuar kuadrin rregullator dhe standardet për sigurimin e cilësisë. Rregullorja e Universitetit të Tiranës, në nenet 92, 93 dhe 94, përcakton të drejtat e studentëve për të kontribuar në vlerësimin e proceseve akademike, për të dhënë mendime mbi cilësinë e mësimdhënies dhe për të qenë të përfaqësuar në struktura vendimmarrëse dhe këshilluese. Edhe Rregullorja e Programit të Studimit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim" parashikon të drejtat e studentëve për përfshirje në vendimmarrje dhe vlerësimin mbi procesin akademik. Kjo kryhet në praktikë nëpërmjet instrumenteve të brendshme të sigurimit të cilësisë. Studentët plotësojnë periodikisht pyetësorë vlerësues mbi performancën e pedagogëve, të cilët administrohen nga strukturat përkatëse të cilësisë në nivel fakulteti dhe universiteti. Këto të dhëna përpunohen në mënyrë të strukturuar dhe shërbejnë si bazë për përmirësimin e praktikave mësimore dhe organizative, duke u reflektuar në analiza dhe vendimmarrje të matshme e të verifikueshme. Gjithashtu, një anëtar i Këshillit Studentor merr pjesë në mbledhjet e Departamentit, ku paraqet në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkesat, shqetësimet dhe rekomandimet e studentëve lidhur me procesin akademik. <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "Bachelor në Gazetari dhe Komunikim"</i> <i>E.2.11. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit (Shembull)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Njësia përgjegjëse e programit të studimit garanton përfshirjen aktive dhe të strukturuar të studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, në përputhje me standardet institucionale dhe praktikën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Studentët kontribuojnë në këtë proces përmes instrumenteve të rregullta dhe të dokumentuara si pyetësorë të vlerësimit të lëndëve dhe stafit akademik, të cilët përpunohen nga strukturat përgjegjëse dhe ndikojnë në rishikimin e përmbajtjes së moduleve, mbledhje të departamentit, ku përfaqësuesit studentorë, përmes Këshillit Studentor, paraqesin sugjerime konkrete mbi përmirësimin e programit, fokus grupet apo

	konsultimet direkte me studentët, të cilat shërbejnë si burim i vlefshëm për reflektim dhe adaptim të vazhdueshëm të programeve. Gjatë vizitës së zhvilluar nga grupi i vlerësimit të jashtëm, vetë studentët konfirmuan dhe vlerësuan përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse si një nga aspektet më të rëndësishme të përvojës së tyre akademike, duke theksuar gjithashtu marëdhëniet pozitive dhe bashkëpunuese me stafin akademik. <i>E.2.11. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit (Shembull)</i> <i>E.6.2. Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.6.5. Pyetësori i stafit akademik</i> <i>E.6.6. Raporti i vlerësimit të lëndëve nga pyetësori i studentëve</i> <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i> <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Institucioni garanton që studentëve u ofrohet mundësia reale dhe e strukturuar për të dhënë mendimin e tyre lidhur me barazinë dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në këtë kuadër, studentët informohen qartë për të gjitha procedurat dhe kriteret e vlerësimit, si dhe për mekanizmat e ankimit dhe rishikimit të rezultateve. Rregullorja e UT-së përcakton qartë të drejtën e studentëve për të kërkuar rishikimin e rezultateve dhe mënyrën e paraqitjes së ankesave. Gjithashtu, zbatohen procedura transparente për ankimin e rezultateve të provimeve, ku studenti mund të paraqesë kërkesë zyrtare për rishikim pranë njesisë bazë ose njesisë kryesore. Mundësia e studentëve për të dhënë feedback për procesin e vlerësimit përmes pyetësorëve dhe takimeve me stafin akademik është një tjetër element i rëndësishëm gjatë këtij procesi. <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.6.5. Pyetësori i stafit akademik</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka siguruar përfshirjen aktive të studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, si dhe në proceset e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Studentët kontribuojnë gjithashtu në vlerësimin e metodave të mësimdhënies dhe cilësinë e shërbimeve. Nga intervistat rezulton se përfshirja e tyre është reale dhe efektive. Standardi vlerësohet si i përmbushur plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6


Adresa: "Rruga e Duresit"
Pranë gjimnazit «Qemal Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43 123

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni i Arsimit të Lartë ka ngritur njësi të posaçme dhe ka miratuar procedura të qarta për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të brendshëm. Në kuadër të shërbimit ndaj studentëve funksionojnë Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Sigurimit të Cilësisë në nivel fakulteti dhe universiteti, Sekretaritë Mësimore, si dhe platforma online dhe mjetet digjitale që mundësojnë komunikim efektiv dhe të aksesueshëm. Këto struktura ofrojnë informacion të detajuar dhe të përditësuar mbi programet e studimit, procesin e regjistrimit, zhvillimin e studimeve, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, si dhe mbështetje për çështje akademike dhe administrative. Studentët kanë mundësi të marrin asistencë të drejtpërdrejtë, por edhe në formë elektronike, duke garantuar akses të barabartë dhe efikasitet në shërbime. <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i> <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.4.3. Rregulla të sekretarisë mësimore</i> <i>E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ vlerëson se institucioni ka një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Kjo mbështetje realizohet nëpërmjet strukturave të dedikuara , si Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Sigurimit të Cilësisë, Koordinatorët e programeve, Sekretaritë Mësimore. Për të garantuar një ndjekje të rregullt dhe të qëndrueshme të progresit të studentëve, institucioni përdor instrumente të mirëpërcaktuara të vlerësimit të cilësisë, të tilla si pyetësorët e vlerësimit të programeve të studimit dhe të mësimdhënies, të plotësuar periodikisht nga studentët; vlerësimin e stafit akademik nga studentët, si formë e përfshirjes së tyre në përmirësimin e cilësisë, analizat e brendshme vjetore, monitorimin e të dhënave statistikore, përfshirë përfundimet, transferimet apo suksesin e studentëve në punësim. Institucioni në këtë program studimi ka kapacitete të larta për të ofruar ndihmën e duhur që studentët të kuptojnë tregun e punës, mundësitë, rreziqet dhe sfidat. <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i> <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.2.3. Urdhër për emërimin e koordinatorit të programit të studimit</i> <i>E.6.6. Raporti i vlerësimit të lëndëve nga pyetësori i studentëve</i>



Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Këshillimit të Karrierës ofron mbështetje të strukturuar dhe të vazhdueshme për studentët në drejtim të zhvillimit të aftësive të tyre profesionale dhe orientimit në tregun e punës. Kjo njësi shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe botës së punës, në përputhje me objektivat formues të programit të studimit dhe nevojat e tregut. Zyra ofron informacion të detajuar dhe orientim praktik mbi përfundimin e programit të studimit dhe kërkesat e diplomimit, mbështetje për përzgjedhjen e praktikave profesionale, përfshirë ndihmën për vendosjen në institucione partnere apo organizata mediatike (në rastin e programeve të gazetarisë dhe komunikimit), këshillim për ndërtimin e CV-së, përgatitjen për intervista pune dhe zhvillimin e kompetencave të buta (soft skills), organizimin e takimeve informuese, forumeve të karrierës, ditëve të hapura dhe panairove të punësimit, ku studentët lidhen me përfaqësues të tregut të punës dhe alumni. Gjithashtu, kryen monitorimin e shkallës së punësimit të të diplomuarve, në bashkëpunim me departamentet dhe strukturat përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë. <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Institucioni i Arsimit të Lartë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse si Zyra e Karrierës dhe Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, ka ndërmarrë hapa të qëndrueshëm për të ndjekur situatën e studentëve pas diplomimit, duke mbledhur dhe përpunuar të dhëna të vlefshme mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre. Një nga nismat më domethënëse në këtë drejtim është realizuar në vitin 2019, kur u krye një gjurmim sistematik i të diplomuarve të këtij programi studimi, çka rezultoi në krijimin e një baze të mirëstrukturuar të të dhënave që reflekton situatën reale të vendosjes së tyre në tregun e punës. Ky proces u konceptua jo vetëm si një akt administrativ, por si një mekanizëm me funksion analitik për të vlerësuar nëse programi i studimit përmbush qëllimin e tij formues dhe përgatit studentët për sfidat e tregut të punës. Të dhënat e grumbulluara kanë shërbyer për të informuar procesin e vendimmarrjes institucionale dhe për të përmirësuar ofertën akademike në përputhje me nevojat aktuale të tregut. Për më tepër, këto të dhëna janë përdorur për të orientuar më mirë studentët gjatë procesit të përzgjedhjes së praktikave profesionale dhe për të strukturuar shërbimet e karrierës mbi baza reale dhe të matshme. <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i> <i>E.1.11. Analizë e tregut të punës</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni i arsimit të lartë ka ngritur dhe funksionalizuar njësi të posaçme për pritjen, orientimin dhe këshillimin e studentëve, si dhe për trajtimin e ankesave dhe problematikave të tyre. Këto struktura veprojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe janë të aksesueshme, duke garantuar mbështetje të vazhduar për studentët dhe</i>



	<i>duke reflektuar përkushtim institucional ndaj mirëqenies dhe përfshirjes së tyre në jetën akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në përputhje me kuadrin institucional të Universitetit të Tiranës zbaton akte rregullatore dhe instrumente specifike për sigurimin e cilësisë në procesin mësimor dhe për vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së stafit akademik. Këto përfshijnë Manualin e Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT, i cili përshkruan qartë kriteret dhe procedurat për vlerësimin profesional dhe pedagogjik të stafit, duke mbështetur zhvillimin e tyre akademik në përputhje me standardet kombëtare dhe institucionale të cilësisë. Gjithashtu, Paketa e Instrumenteve të Cilësisë përbën një mjet thelbësor që përfshin instrumente të strukturuar për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave mbi procesin mësimor, përfshirë anketat e studentëve, vetëvlerësimet nga pedagogët dhe raportet e monitorimit të brendshëm. Këto dokumente mbështeten nga Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë në UT, e cila përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e njësive përkatëse, mekanizmat e vlerësimit të brendshëm dhe procedurat për përmirësim të vazhdueshëm institucional. Për më tepër, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, si njësi bazë akademike, ka realizuar një analizë të detajuar të objektivave formues të programit të studimit, ku janë identifikuar përputhshmëritë midis kompetencave të synuara, përmbajtjes lëndore, si dhe metodave pedagogjike të përdorura. Kjo analizë ka ndihmuar në përcaktimin e nevojës për integrimin e qasjeve interaktive dhe të bazuara në praktikë (si puna në grup, trajnimet laboratorike, simulimet dhe projektet mediatike), për të rritur nivelin e përvetësimit dhe aplikimit të njohurive nga ana e studentëve.



	<i>E.6.2. Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i> <i>E.5.1. Analiza e departamentit për objektivat formues të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Për realizimin e Kriterit 2, Institucioni i Arsimit të Lartë ka ndërtuar dhe funksionalizuar një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës për monitorimin dhe vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Ky sistem bazohet në dokumente strategjike dhe rregullatore institucionale, si dhe në veprimtari konkrete të strukturave përgjegjëse. Strategjia e Zhvillimit të UT-së (2023–2028) përcakton qartë objektiva për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve akademike. Brenda këtij kuadri, Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së paraqet instrumentin kryesor për vlerësimin e kompetencave pedagogjike, shkencore dhe organizative të stafit. Ky manual ofron kritere të qarta dhe transparente vlerësimi, të cilat sigurojnë një proces objektiv dhe të standardizuar në të gjitha njësitë akademike të universitetit. Gjithashtu, Urdhri i Dekanit për krijimin e NJSBC-së në FHF përforcon institucionalizimin e këtyre proceseve, duke siguruar funksionimin e tyre në mënyrë të koordinuar dhe të rregullt. Këto elementë dëshmojnë se institucioni ka krijuar një infrastrukturë të mirëorganizuar për vlerësimin dhe zhvillimin e stafit akademik, në përputhje me standardet e arsimit të lartë dhe me kërkesat në rritje të programeve të studimit. <i>E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i> <i>E.6.2. Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së</i> <i>E.6.4. Urdhër i Dekanit për krijimin e NJSBC-së në FHF</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Procesi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies, si dhe të vlerësimit të dijeve, është i institucionalizuar dhe funksional në institucion. Për këtë qëllim është ngritur një komision i posaçëm në kuadër të Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), i cili ka përgjegjësinë për organizimin, monitorimin dhe analizimin e këtij procesi. Ky komision përbëhet nga një grup i balancuar anëtarësh me përfaqësues nga stafi akademik, stafi ndihmësakademik dhe studentët, duke siguruar një përfaqësim të gjerë dhe gjithëpërfshirës. Përbërja e komisionit është si më poshtë: Ky grup punon në mënyrë të koordinuar për mbledhjen e vlerësimeve nga studentët mbi metodat dhe format e mësimdhënies, duke siguruar që edhe ankesa apo shqetësime lidhur me procesin e vlerësimit të dijeve trajtohen në mënyrë transparente dhe efektive. Përfshirja e drejtpërdrejtë e studentëve në këtë mekanizëm garanton që proceset

	mësimore të jenë të adaptuara dhe përmirësohen vazhdimisht, në përputhje me nevojat dhe pritshmëritë e tyre. Sikurse është raportuar më sipër, përdoren metoda dhe instrumente të ndryshme që demonstrojnë përfshirjen aktive të studentëve në procesin e vlerësimit. Ndër to përfshihen pyetësorët anonimë, të cilët sigurojnë një mjedis të hapur dhe të besueshëm për shprehjen e mendimeve mbi cilësinë e mësimdhënies dhe metodave të përdorura. <i>E.6.4. Urdhër i Dekanit për krijimin e NJSBC-së në FHF</i> <i>E.6.6. Raporti i vlerësimit të lëndëve nga pyetësi i studentëve</i> <i>E.2.11. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit (Shembull)</i> <i>E.6.5. Pyetësi i stafit akademik</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Kriteri 4, që lidhet me publikimin e rezultateve të vlerësimit nga strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, është e parashikuar qartësisht në kuadrin rregullator të Universitetit të Tiranës. Konkretisht, Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 14, datë 20.07.2022, në nenin 6 përcakton strukturën në tre nivele: njësitë bazë, njësinë kryesore dhe atë institucionale. Nenet 7 dhe 8 sanksionojnë detyrat funksionale të këtyre strukturave, duke theksuar rëndësinë e monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të cilësisë në procesin mësimor. Në mënyrë të veçantë, neni 8, pika d, parashikon që “njësia kryesore e sigurimit të cilësisë ka detyrimin të vlerësojë dhe të publikojë të gjitha veprimtaritë e përgatitura nga njësitë bazë mbi zhvillimin e standardeve të cilësisë, në kuadrin e Paketës së Instrumenteve të Cilësisë, Manualit të Sigurimit të Cilësisë dhe Rregullores së Sigurimit të Brendshëm të UT-së”. Megjithatë, për të dokumentuar zbatimin praktik të këtij kriteri, në kuadër të procesit të vlerësimit sugjerohet që institucioni të vërë në dispozicion evidenca të mjaftueshme që të demonstrojnë bërjen publike të rezultateve të vlerësimit nga strukturat përkatëse në mënyrë të rregullt. Kjo krijon nevojën për forcimin e transparencës institucionale nëpërmjet dokumentimit dhe shpërndarjes më të gjerë të rezultateve të vlerësimeve në të gjitha nivelet. https://unitir.edu.al/rregullore-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ne-universitetin-e-tiranes/
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për	Universiteti i Tiranës ka ngritur struktura funksionale dhe ka miratuar instrumente të posaçme për sigurimin e cilësisë, si Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik, Paketa e Instrumenteve të Cilësisë, si dhe Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë, të cilat parashikojnë identifikimin dhe shpërndarjen e praktikave të mira në procesin mësimor. Gjithashtu, rezultatet e vlerësimeve periodike, të realizuara përmes pyetësorëve për studentët dhe vetëvlerësimeve nga

përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	personeli akademik, përdoren për të nxjerrë në pah shembuj të suksesshëm të metodave inovative të mësimdhënies dhe për të ndarë këto praktika me pjesën tjetër të stafit akademik. Këto të dhëna u shërbejnë strukturave përgjegjëse për të hartuar rekomandime dhe politika mbështetëse, të cilat synojnë motivimin e stafit për të përmirësuar më tej cilësinë e mësimdhënies dhe për të rritur ndërveprimin me studentët. Për më tepër, zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme, promovimi i pjesëmarrjes në konferenca dhe publikime akademike, si dhe vlerësimi përmes performancës, kontribuojnë në krijimin e një kulture institucionale të përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie. <i>E.6.2. Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i>			
Konkluzione	UT ka ndjekur një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë në mësimdhënie. Kjo realizohet përmes miratimit të dokumenteve strategjike si Strategjia e Zhvillimit të UT-së, Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik, Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë dhe Paketa e Instrumenteve të Cilësisë. Për më tepër, janë hartuar udhëzues të posaçëm dhe janë ngritur struktura të përhershme monitorimi, si njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në të tri nivelet institucionale. Përmes këtyre mekanizmave, sigurohet zhvillimi i metodave të mësimdhënies dhe vlerësimi i tyre në mënyrë periodike, duke dëshmuar një angazhim institucional për përmirësim të vazhdueshëm dhe standarde të larta akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Universiteti i Tiranës ka ngritur politika, struktura dhe procedura të qarta për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore institucionale. Kjo është e konfirmuar qartë edhe në Statutin e UT-së, ku në Kreun I (Nenet 1–8) përcaktohen parimet themelore të autonomisë, transparencës, kolegjalitetit dhe rolit të strukturave për cilësinë, duke përfshirë edhe ndërtimin e një sistemi institucional për sigurimin e cilësisë. Në vijim, në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e njësive të SBC, e miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 14, datë 20.07.2022, në

	nenin 6 institucionalizohen tre nivele funksionimi (njësitë bazë, njësia kryesore dhe njësia në nivel institucional), ndërsa nenet 7–8 përcaktojnë detyrat përkatëse, duke përfshirë monitorimin, vlerësimin dhe publikimin e rezultateve të cilësisë. Dokumentet mbështetëse si Paketa e Instrumenteve të Cilësisë, Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik, si dhe Strategjia e Zhvillimit të UT-së 2023–2028, plotësojnë këtë kuadër duke ofruar udhëzues praktikë, instrumente dhe nga procedura operative për implementimin e politikave të SBC-së. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.6.2. Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> https://unitir.edu.al/rregullore-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ne-universitetin-e-tiranes/
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Universiteti i Tiranës ka ngritur dhe operon në mënyrë të qëndrueshme me një Sistem të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBC), i cili bazohet në parimet e transparencës, pjesëmarrjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Ky sistem është i ndërtuar në tre nivele organizative: në njësitë bazë, njësitë kryesore dhe në nivelin institucional, duke mundësuar një strukturë funksionale dhe të decentralizuar për menaxhimin e cilësisë. Zbatimi i strategjisë institucionale për përmirësimin e cilësisë realizohet përmes planifikimit të veprimeve periodike, hartimit të raporteve të vlerësimit dhe analizës së të dhënave që merren nga mekanizma të rregullt monitorimi. Studentët marrin pjesë aktivisht në këtë proces përmes pyetësorëve të anonimizuar, duke dhënë mendime mbi përvojën e tyre akademike dhe administrative. Këto të dhëna përpunohen dhe analizohen nga strukturat përgjegjëse të cilësisë për të gjeneruar masa konkrete për përmirësim. Gjithashtu, për të siguruar objektivitet dhe standarde të jashtme, institucioni përfshin në vlerësim ekspertë të jashtëm dhe bashkëpunëtorë nga fusha akademike dhe profesionale, të cilët kontribuojnë me rekomandime për forcimin e praktikave të mësimdhënies, kërkimit dhe menaxhimit akademik. Më konkretisht, në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit mësimor në profilin Gazetari dhe Komunikim, është ndërmarrë një proces shumëvjeçar reformimi, i cili ka zgjatur më shumë se tre vjet, duke nisur nga viti 2018. Ky proces është realizuar në bashkëpunim me aktorë ndërkombëtarë, si OSBE, USAID, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, si dhe universitete dhe shkolla gazetarie në Angli dhe Francë. Janë angazhuar ekspertë të huaj me përvojë, të cilët kanë ofruar një analizë të thelluar të gjendjes ekzistuese dhe kanë formuluar propozime



	konkrete për ndërtimin e një plani të ri mësimor, të cilat në pjesën më të madhe janë marrë parasysh. Gjithashtu, procesi ka përfshirë studime empirike dhe anketime të strukturuar me studentë, gazetarë në profesion, publikun e gjerë dhe audiencat mediatike, me qëllim vjeljen e mendimeve mbi cilësinë e arsimit në këtë fushë. Në vijimësi, është kryer një analizë e kapaciteteve përthithëse të tregut të punës në sektorin mediatik, duke siguruar që plani i ri të përputhet me kërkesat reale të industrisë dhe të kontribuojë në përgatitjen profesionale të studentëve. <i>E.5.1. Analiza e departamentit për objektivat formues të programit të studimit</i> <i>E.6.8. Agjenda e takimeve me bashkëpunëtorë vendas dhe të huaj</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti i Tiranës ka institucionalizuar përdorimin e një game të gjerë instrumentesh dhe treguesish për sigurimin e cilësisë, të cilat mbështeten në standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë realizohen kryesisht përmes akreditimit të programeve të studimit, i cili mbikëqyret nga Autoriteti Kombëtar i Akreditimit dhe Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe kërkesa për përputhje me kriteret e përcaktuara ligjore. Përveç akreditimit, Universiteti angazhohet në vlerësime analitike dhe krahasuese të programeve të studimit, duke përdorur tregues të ndryshëm cilësorë dhe sasiore që reflektojnë performancën akademike, përmbushjen e objektivave mësimore dhe kërkesat e tregut të punës. Këto vlerësime plotësohen me auditime të brendshme dhe raporte periodike të njëjësive të sigurimit të cilësisë, të cilat bashkëpunojnë ngushtë me ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm. <i>E.5.1. Analiza e departamentit për objektivat formues të programit të studimit</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ ka konstatuar se zbatohen në mënyrë sistematike tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie, të cilët janë të parashikuara në aktet rregullatore institucionale dhe dokumentet e brendshme të sigurimit të cilësisë. Këta tregues përfshijnë indikatorë të performancës në mësimdhënie, rezultatet e studentëve, nivelin e përfshirjes në kërkimin shkencor, si dhe parametrat e përmbushjes së standardeve akademike dhe ligjore. Përveç pasqyrimin të gjendjes së përgjithshme në proceset mësimore dhe kërkimore, këta tregues shërbejnë si bazë për vendimmarrje strategjike dhe veprime për përmirësimin e cilësisë. Institucioni zhvillon mekanizma promovimi dhe nxitjeje, duke evidentuar arritjet e stafit akademik dhe studentëve, si dhe duke inkurajuar inovacionin dhe zhvillimin profesional.

	E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT			
Konkluzione	GVJ vëren se UT-ja ka vendosur dhe zbatuar politika dhe procedura transparente për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, brenda një sistemi të brendshëm të mirëorganizuar. Ky sistem siguron monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë, duke përfshirë aktorët kryesorë dhe duke garantuar përputhshmërinë me standardet ligjore dhe institucionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Institucioni i arsimit të lartë ka ngritur dhe zbaton mekanizma dhe procedura të mirëpërcaktuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, duke i orientuar këto procese drejt standardeve të akreditimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Në përputhje me Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës, veçanërisht Nenin 26, parashikohet që çdo njësi bazë duhet të kryejë vlerësimin periodik të programeve të studimit dhe të hartojë raporte cilësore vlerësuese për arritjet, mangësitë dhe përmirësimet e mundshme. Këto raporte shërbejnë si bazë për vendimmarrje të informuar nga autoritetet përgjegjëse të institucionit dhe për forcimin e kulturës së përgjegjshmërisë akademike. Në mënyrë të veçantë, departamenti i GK ka realizuar një analizë SWOT për të vlerësuar objektivat formues të programit të studimit. Kjo analizë ka shërbyer si një instrument i rëndësishëm për të identifikuar forcën dhe potencialin e brendshëm të programit, dobësitë që kërkojnë ndërhyrje strategjike, mundësitë që lidhen me tregun e punës dhe zhvillimet akademike, si dhe kërcënimet që lidhen me mjedisin konkurrues dhe zhvillimet institucionale. Rezultatet e analizës janë dokumentuar dhe janë vënë në dispozicion të strukturave përgjegjëse akademike dhe vendimmarrëse, duke siguruar një bazë të qëndrueshme për mbikëqyrjen cilësore dhe akreditimin e programit të studimit.
	E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT E.5.1. Analiza e departamentit për objektivat formues të programit të studimit
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e	GVJ vëren se institucioni ka zhvilluar një praktikë të konsoliduar për hartimin e raporteve periodike të vlerësimit, të cilat përfshijnë rezultatet

pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	e pritshme të programit të studimit, analizën e rezultateve të arritura dhe identifikimin e praktikave të suksesshme në procesin mësimor dhe kërkimor. Raportet evidentojnë shembuj të praktikave të mira dhe shërbejnë si bazë për motivimin e stafit akademik dhe studentëve, përmes masave stimuluese dhe promovimit të cilësisë. Gjithashtu, këto dokumente përmbajnë një plan konkret masash për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë, në përputhje me paketën e instrumenteve të cilësisë në UT. Procesi përfshin analiza të strukturuar të indikatorëve të performancës dhe është i dokumentuar. Vlerësimi i performancës së stafit akademik bazohet mbi një qasje të integruar që përfshin vetëvlerësimin individual të pedagogut, vlerësimin periodik nga eprori, vlerësimin nga studentët. <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i> <i>E.1.7. Raport i analizës vjetore të Departamentit</i> <i>E.6.5. Pyetësi i stafit akademik</i> <i>E.6.6. Raporti i vlerësimit të lëndëve nga pyetësi i studentëve</i> <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Në kuadër të strukturave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë ndërtuar mekanizma për vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënit. Këto përfshijnë: - Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studentët, përmes pyetësorëve të standardizuar të shpërndarë në fund të çdo semestri; - Vlerësimin e didaktikës dhe kurrikulës nga strukturat përgjegjëse (njësitë bazë dhe departamentet), në përputhje me Rregulloren e Brendshme për Sigurimin e Cilësisë; - Vëzhgime në auditor nga anëtarë të stafit akademik apo nga përfaqësues të NJSBC-së për të analizuar aspektet metodologjike të mësimdhënies dhe angazhimit të studentëve; - Analizë e feedback-ut të alumnive dhe punëdhënësve, për të pasur një reflektim të jashtëm mbi cilësinë e përgatitjes profesionale të të diplomuarve. Të gjitha këto mekanizma përdoren për të prodhuar raporte analitike që diskutohen në strukturat përkatëse dhe shërbejnë si bazë për ndërhyrje përmirësuese në programin e studimit. Në këtë mënyrë, institucioni garanton një qasje të qëndrueshme dhe të matshme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë, në përputhje me standardet e Akreditimit dhe Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë. <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të	Në praktikën institucionale, vlerësimi i cilësisë së programit realizohet përmes:

realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	- Sondazheve periodike me studentët aktivë, të cilët vlerësojnë përmbajtjen, organizimin, metodat e mësimdhënies, dhe ngarkesën akademike të programit; - Intervistave strukturuara dhe pyetësorëve për alumnit, për të matur koherencën midis aftësive të përfuara gjatë studimeve dhe kërkesave reale të tregut të punës; - Konsultimeve me punëdhënësit dhe institucionet partnere, për të vlerësuar nëse programi akademik përgatit profesionalisht studentët dhe për të marrë sugjerime për përmirësim; - Feedback-ut nga stafi akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, në lidhje me menaxhimin institucional, burimet, infrastrukturën, si dhe sfidat e zbatimit të programit; - Tryezave të rumbullakëta dhe fokus grupeve, që zhvillohen në bashkëpunim me përfaqësues nga komuniteti akademik dhe sektori jo akademik, për të marrë mendime mbi efektivitetin e programit. Rezultatet e këtyre vlerësimeve sintetizohen në raporte përkatëse nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe diskutohen në nivele të ndryshme të vendimmarrjes. <i>E.5.1. Analiza e departamentit për objektivat formues të programit të studimit</i> <i>E.6.8. Agjenda e takimeve me bashkëpunëtorë vendas dhe të huaj</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>			
Konkluzione	Bazuar në informacionin e dokumentuar dhe në të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se standardi përmbushet në mënyrë të plotë. Universiteti i Tiranës, nëpërmjet strukturave të dedikuara për sigurimin e cilësisë, realizon monitorim dhe vlerësim periodik të programit të studimit. Këto procese synojnë të garantojnë përmbushjen e objektivave formuese dhe arritjen e rezultateve të parashikuara të të nxënit, në përputhje me kërkesat e standardeve akademike dhe zhvillimet e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë	Në përmbushje të kriterit për përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë ka krijuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e përbërë nga

përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	10 anëtarë me profile të ndryshme profesionale. Në këtë njësi janë përfshirë 2 profesorë me titull akademik Prof. Dr., 3 me titull Prof. As. Dr., 1 doktor, 1 me Master Shkencor, një staf ndihmës administrativ si dhe 2 studentë të nivelit master. Kjo përbërje e balancuar siguron një angazhim gjithëpërfshirës, duke përfshirë ekspertizën akademike, përfaqësimin administrativ dhe zërin e studentëve, duke garantuar në këtë mënyrë pjesëmarrjen aktive të aktorëve të ndryshëm në proceset e sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Gjithashtu, proceset e rishikimit të programeve të studimit përfshijnë feedback-un e mbledhur në mënyrë sistematike përmes instrumenteve të tilla si anketat, intervistat, grupet e fokusit dhe analizat e tregut të punës, duke mundësuar identifikimin e nevojave të vazhdueshme për përmirësim dhe përshtatje të kurrikulës. <i>E.6.8. Agjenda e takimeve me bashkëpunëtorë vendas dhe të huaj</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.1.11. Analizë e tregut të punës</i> <i>E.1.12. Studimi i tregut - Media in fokus</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Konkretisht, Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 14, datë 20.07.2022, në nenin 6 përcakton strukturën në tre nivele: njësitë bazë, njësinë kryesore dhe atë institucionale. Nenet 7 dhe 8 sanksionojnë detyrat funksionale të këtyre strukturave, duke theksuar rëndësinë e monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të cilësisë në procesin mësimor. Përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara në këtë rregullore garantojnë ushtrimin me përkushtim dhe përgjegjësi të detyrave të të gjithë aktorëve të përfshirë, duke siguruar funksionimin efikas dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> https://unitir.edu.al/rregullore-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ne-universitetin-e-tiranes/
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit	Në përputhje me nenin 6 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Universitetin e Tiranës, struktura e sistemit të sigurimit të cilësisë është e ndarë në tri nivele: njësia bazë (në nivel departamenti), njësia kryesore (në nivel fakulteti) dhe njësia institucionale (në nivel universiteti). Kjo strukturë funksionale garanton përfshirjen e gjerë dhe gjithëpërfshirëse të aktorëve relevantë në procesin e sigurimit të

akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	cilësisë, duke ndërtuar ura komunikimi dhe bashkëpunimi midis niveleve të ndryshme akademike dhe administrative. Në nivel institucional, në Rektoratin e Universitetit të Tiranës funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSB), e përbërë nga 9 anëtarë: një staf akademik me kohë të plotë i propozuar nga secili prej fakulteteve, një ekspert i jashtëm i caktuar nga Rektori, si dhe një student i përzgjedhur nga Këshilli i Studentëve. Kjo përbërje siguron një përfaqësim të balancuar të interesave akademike, studentore dhe ekspertizës së jashtme në procesin e monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. https://unitir.edu.al/rregullore-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ne-universitetin-e-tiranes/
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Universiteti i Tiranës, nëpërmjet strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, ka përcaktuar qartë në aktet e tij të brendshme se përfshirja e aktorëve të brendshëm përfshirë personelin akademik, ndihmësakademik dhe studentët në proceset ciklike të vlerësimit, realizohet në mënyrë transparente, paanshme dhe të dokumentuar. Kjo përfshirje ndihmon jo vetëm në reflektimin objektiv të cilësisë, por edhe në krijimin e një mjedisi akademik të drejtë dhe gjithëpërfshirës, ku respektohen të drejtat dhe dinjiteti i çdo pjesëmarrësi. Institucioni shmang çdo formë diskriminimi apo trajtimi të pabarabartë dhe ndërmerr masa parandaluese dhe korrigjuese në rastet kur cenohen parimet e etikës akademike. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vrya në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Përmbushja e Kriterit 5 reflektohet qartë në angazhimin e Universitetit të Tiranës për të përfshirë në mënyrë aktive bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit. Në përbërjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional (NJSBC), është parashikuar pjesëmarrja e një eksperti të jashtëm, i emëruar me propozim të Rektorit, i cili sjell një perspektivë të pavarur dhe një kontribut profesional të vlefshëm në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike. Një shembull konkret i këtij angazhimi është ndërmarrja nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit e një procesi gjithëpërfshirës për rishikimin dhe modernizimin e programit mësimor dhe të kurrikulës. Ky riorganizim është realizuar në bashkëpunim me institucione akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, si Leicester Media School (University of De Montfort), dhe është mbështetur financiarisht nga partnerë të rëndësishëm si USAID dhe Ambasada Britanike në Tiranë. Gjatë këtij procesi janë zhvilluar analiza të

	hollësishme mbi sfidat ekzistuese dhe kërkesat e tregut të punës, si dhe janë organizuar anketime dhe konsultime me grupe interesi. Si rezultat, kurrikula është riformuluar për të reflektuar zhvillimet bashkëkohore në fushën e medias dhe komunikimit, duke siguruar përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe nevojat e tregut vendas. Ky rast paraqet një model të mirë se si përfshirja aktive e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm ndihmon në ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe përshtatjen e tij me realitetin dinamik profesional. <i>E.5.1. Analiza e departamentit për objektivat formues të programit të studimit</i> <i>E.6.8. Agjenda e takimeve me bashkëpunëtorë vendas dhe të huaj</i> https://unitir.edu.al/rregullore-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ne-universitetin-e-tiranes/			
Konkluzione	GVJ vlerëson se Universiteti i Tiranës përfshin në mënyrë të strukturuar dhe funksionale njësitë akademike, personelin akademik dhe studentët në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë, si në nivel institucional ashtu edhe në nivelin e programit të studimit "Gazetari dhe Komunikim". Gjithashtu, sigurohet transparencë në shpërndarjen dhe komunikimin e informacionit që buron nga proceset e vlerësimit. Në këtë kuadër, GVJ konkludon se standardi përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Universiteti i Tiranës është i angazhuar për të garantuar transparencë dhe akses publik në lidhje me politikat, strategjitë dhe veprimtaritë e ndërmarra në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit. Rregulloret përkatëse, dokumentet strategjike dhe raportet e vlerësimit publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe janë të aksesueshme për studentët, personelin akademik dhe palët e tjera të interesuara. Gjithashtu, informacionet për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), përfshirë përbërjen, detyrat, aktivitetet monitoruese dhe masat për përmirësim, bëhen të njohura përmes takimeve informuese, platformave elektronike dhe përfaqësimit të studentëve në strukturat përkatëse. <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i>

Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Universiteti i Tiranës i vlerëson tejet të rëndësishme çështjet e etikës dhe lirisë akademike, duke i konsideruar ato si elemente thelbësore për garantimin e cilësisë dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor. Në lidhje me të dhënat e detajuara që rrjedhin nga anketimet dhe monitorimet e programeve të veçanta të studimit, institucioni i trajton këto të dhëna si të ndjeshme dhe i menaxhon me kujdes, duke respektuar konfidencialitetin e tyre. Informacioni i mbledhur nga proceset e monitorimit ndjek një hierarki të qartë të vendimmarrjes, duke u përcjellë drejt drejtuesve kryesorë si Rektori, Administratori dhe dekanët e fakulteteve përkatëse. Raportet e detajuara, që përmbajnë edhe të dhëna specifike, përdoren si pjesë e politikës institucionale për vlerësimin e performancës akademike, proces ky që zhvillohet në përfundim të çdo viti akademik nga eprorët përkatës me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe standardeve akademike. Megjithatë, sugjerohet që institucioni të dokumentojë në mënyrë sistematike procesin e publikimit të rezultateve të vlerësimeve, duke përfshirë format dhe mënyrat e shpërndarjes së informacionit. Kjo do të rrisë transparencën, do të sigurojë akses të barabartë për të gjithë aktorët e interesuar dhe do të forcojë besimin në sistemin e sigurimit të cilësisë. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Universiteti i Tiranës aplikon një proces të integruar ku rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit shoqërohen me plane konkrete veprimi, të cilat synojnë adresimin e dobësive dhe mangësive të identifikuar. Këto plane masash përgatiten në bazë të analizës së detajuar të të dhënave të mbledhura gjatë vlerësimeve dhe përfshijnë afate kohore, përgjegjëse specifike dhe burime të nevojshme për zbatimin efektiv të tyre. Procesi siguron një qasje sistematike për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, duke garantuar kështu rritjen e performancës akademike dhe përshtatjen e mësimdhënies me standardet bashkëkohore. <i>E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i> <i>E.1.4. Plani i Zhvillimit të Departamentit të Gazetarisë 2024-2029</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UT ka vendosur mekanizma të qëndrueshëm dhe të sistematizuar për të vlerësuar efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë në programet e studimit. Përmes analizave periodike dhe raporteve të detajuara, institucioni identifikon se në ç'mënyrë rezultatet e këtyre veprimtarive kontribuojnë në përmirësimin konkret të përmbajtjes, metodologjisë dhe organizimit të mësimdhënies. Ky proces përfshin rikthimin e informacionit tek njësitë përgjegjëse dhe aktorët kyç, si dhe përshtatjen e planifikimeve dhe politikave të cilësisë, duke garantuar kështu një zhvillim të qëndrueshëm dhe të bazuar në të dhëna të programeve të studimit.

	Veprimtaria e vlerësimit dhe monitorimit realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar kërkesat e ligjit për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore që rregullojnë sigurimin e cilësisë në arsimin universitar në Shqipëri. <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	UT organizon në mënyrë të rregullt veprimtari dhe takime informative me pjesëmarrjen aktive të personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve, me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e tyre në proceset e sigurimit dhe përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit. Këto veprimtari përfshijnë seminare, trajnime, prezantime të rezultateve të vlerësimeve dhe konsultime të hapura, duke siguruar kështu një dialog konstruktiv dhe transparent midis të gjitha palëve të përfshira. Ky angazhim i vazhdueshëm ndihmon në promovimin e një kulture të përgjegjshmërisë kolektive për cilësinë akademike dhe në përmirësimin sistematik të programeve, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe me kuadrin ligjor dhe nënligjor që rregullon arsimin e lartë në vend. <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i> <i>E.3.9. Listë trajnimesh prej Zyrës së Këshillimit të Karrierës</i>			
Konkluzione	Duke u bazuar në informacionin e ofruar dhe në vëzhgimet e kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se standardi konsiderohet i përmbushur në mënyrë të plotë. Universiteti i Tiranës ka zhvilluar politika, procese dhe veprimtari të strukturuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, të cilat karakterizohen nga transparenca dhe aksesueshmëria për publikun e gjerë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universitetit i Tiranës”

Pikat e forta:

→ **Kurrikulë bashkëkohore dhe e përditësuar**

Programi i studimit ofron një kurrikulë bashkëkohore, e ndërtuar mbi literatura moderne dhe burime të përditësuara, të cilat përputhen me zhvillimet akademike dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Kjo i mundëson studentëve të përvetësojnë njohuri dhe aftësi të nevojshme për integrimin efektiv në tregun e punës.

→ **Staf akademik i kualifikuar, i përkushtuar dhe me profil kërkimor të spikatur**

Programi mbështetet nga një staf akademik me kualifikime të larta shkencore dhe përvojë të pasur në fushën e gazetarisë dhe komunikimit. Pedagogët janë të përkushtuar ndaj mësimdhënies dhe zhvillimit profesional të studentëve, ndërkohë që kontribuojnë ndjeshëm në kërkimin shkencor përmes botimeve, pjesëmarrjes në konferenca, projekteve kombëtare e ndërkombëtare dhe veprimtarive të tjera akademike që forcojnë profilin dhe reputacionin e institucionit.

→ **Infrastrukturë funksionale dhe kushte optimale mësimi**

Institucioni ofron ambiente moderne dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, të pajisura me mjete teknologjike dhe laboratorë të nevojshëm për praktikën profesionale në fushën e medias dhe komunikimit.

→ **Mbështetje financiare dhe tarifa të arsyeshme**

Politikat institucionale favorizojnë përfshirjen sociale nëpërmjet tarifave të përballueshme për shtresat në nevojë dhe mbështetjes për studentët ekselentë, duke promovuar barazi dhe akses në arsim cilësor.

→ **Strategji zhvillimi dhe procedura të mirëpërcaktuara**

Programi është i orientuar nga një strategji e qartë zhvillimi afatmesëm dhe afatgjatë, duke përfshirë mekanizma të konsoliduar për rishikimin periodik të plan-programeve dhe aplikimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies.

→ **Marrëveshje bashkëpunimi dhe lidhje me tregun e punës**

Programi përfiton nga marrëveshjet e bashkëpunimit me media, institucione publike dhe private, si dhe organizata partnere, të cilat mbështesin përfshirjen e studentëve në praktikën profesionale dhe orientimin e tyre drejt tregut të punës.

→ **Angazhim në veprimtari praktike dhe kërkimore**

Studentët marrin pjesë rregullisht në veprimtari praktike dhe projekte kërkimore, përmes organizimit të tryezave, konferencave, analizës së lajmit, praktikave profesionale dhe pjesëmarrjes në forume mediatike.

→ **Ndërveprim i mirë me studentët dhe kultura institucionale mbështetëse**

Departamenti karakterizohet nga një kulturë bashkëpunimi dhe komunikimi të hapur me studentët, duke nxitur përfshirjen e tyre aktive në proceset akademike dhe institucionale.

Rekomandime:

→ **Zhvillimi i Strategjive Promovuese për Rritjen e Numrit të Studentëve**



Rekomandohet që institucioni të hartojë dhe zbatojë një strategji gjithëpërfshirëse promovimi të programit, e bazuar në analiza të tregut të punës, në trendet e medias dhe komunikimit, dhe në konsultime me alumni e aktorë të industrisë. Strategjia duhet të përfshijë gjithashtu orientimin drejt tregjeve rajonale dhe afrimin e studentëve nga trevat shqipfolëse jashtë kufijve të Shqipërisë.

→ **Nxitja e reflektimit institucional mbi qëndrueshmërinë e programit**

Këshillohet zhvillimi i forumeve të brendshme reflektuese me stafin akademik për të adresuar çështjen e rënies së interesit dhe ndikimin e saj në misionin akademik dhe organizimin pedagogjik. Këto diskutime mund të kontribuojnë në riformulimin e objektivave dhe rritjen e angazhimit në zhvillimin e mëtejshëm të programit.

→ **Dokumentimi dhe Publikimi i Rregullt i Rezultateve të Vlerësimeve të Cilësisë**

Sugjerohet fuqimisht që institucioni të zhvillojë një sistem të mirëpërcaktuar dhe të dokumentuar për publikimin periodik dhe transparent të rezultateve të vlerësimeve të brendshme të cilësisë. Ky proces duhet të jetë i integruar me formatet dhe mekanizmat e shpërndarjes që sigurojnë akses të barabartë për të gjithë aktorët e interesuar përfshirë studentët, stafin akademik dhe administrativ, si dhe partnerët institucionalë.

Në mënyrë të veçantë, zbatimi i nenit 8, pika d të rregullores së brendshme të UT-së, që kërkon publikimin e aktiviteteve të njëjësive bazë lidhur me standardet e cilësisë, duhet të mbështetet nga evidenca të verifikueshme dhe të qasshme. Kjo do të forcojë jo vetëm transparencën institucionale, por edhe besimin publik në sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë.

→ **Zgjerimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit Ndërinstitucional dhe Ndërkombëtar**

Edhe pse institucioni gëzon një marrëdhënie të konsoliduar bashkëpunimi me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), rekomandohet që të rishikohet dhe të zgjerohet gama e bashkëpunimeve me aktorë të tjerë institucionalë, përfshirë mediat e reja, agjencitë e pavarura të komunikimit, organizatat jofitimprurëse dhe partnerë ndërkombëtarë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit. Zhvillimi i projekteve të përbashkëta kërkimore, shkëmbimeve akademike dhe praktikave studentore ndërkombëtare do të përmirësojë ndjeshëm profilin ndërkombëtar të programit dhe do të nxisë rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

→ **Përmirësimi i Menaxhimit dhe Dokumentimit të Regjistrit të Arritjeve Akademike**

Gjatë vizitës së vlerësimit u evidentua se regjistri fizik i arritjeve të studentëve nuk ishte plotësuar në mënyrë të plotë nga sekretaria mësimore, ndonëse të dhënat përkatëse ruheshin në formatin elektronik. Edhe pse përdorimi i databazave digjitale për menaxhimin e të dhënave është një praktikë efikase dhe moderne, plotësimi i regjistrit fizik mbetet një detyrim formal dhe funksional në përputhje me kërkesat e standardeve të akreditimit dhe kuadrit rregullator të arsimit të lartë në Shqipëri.

Për këtë arsye, institucioni rekomandohet të ndërmarrë masa konkrete për të siguruar përditësimin dhe mirëmbajtjen e rregullt të regjistrit fizik të arritjeve akademike, duke forcuar përgjegjësitë e strukturave të ngarkuara dhe duke garantuar përputhshmëri të plotë ndërmjet dokumentacionit fizik dhe atij elektronik. Kjo masë është e domosdoshme për të përmbushur standardet ligjore dhe për të rritur besueshmërinë e sistemit të administrimit të të dhënave akademike.

→ **Rekomandim për analizën SWOT të programit Bachelor në Gazetari dhe Komunikim**

Gjatë shqyrtimit të analizës SWOT të paraqitur nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit u konstatua se disa nga elementët e listuar si “dobësi” nuk përfaqësojnë në mënyrë të saktë dobësi të brendshme të programit të studimit, por janë më tepër sfida apo kërcënime që burojnë nga faktorë të jashtëm (si cilësia e arsimit parauniversitar apo mospërputhja e tregut të punës me përgatitjen akademike). Për këtë arsye rekomandohet që institucioni në të mirën e punës së tij të bëjë një analizë SWOT reale, duke bërë një ndarje të qartë midis dobësive të brendshme (aspekte që varen nga vetë programi) dhe kërcënimeve të jashtme (sfida që vijnë nga mjedisi i jashtëm, si konkurrenca në treg, ndryshimet në profilin e studentëve, zhvillimet në tregun mediatik apo politikat arsimore në nivel kombëtar). IAL rekomandohet të përdorë standarde të pranuara ndërkombëtare në hartimin e analizave SWOT, në mënyrë që kjo analizë të jetë një mjet real për përmirësim të brendshëm dhe planifikim strategjik.

Conclusions of the Evaluation of the Bachelor's Study Program in “Journalism and Communication” Offered by the Higher Education Institution “University of Tirana”

Strengths:

→ **Contemporary and Updated Curriculum**

The study program offers a modern curriculum based on up-to-date literature and resources aligned with academic developments and international best practices. This enables students to acquire the necessary knowledge and skills for effective integration into the labor market.

→ **Qualified, Dedicated Academic Staff with a Distinguished Research Profile**

The program is supported by highly qualified academic staff with extensive experience in journalism and communication. The lecturers are committed to teaching and the professional development of students while contributing significantly to scientific research through publications, participation in conferences, national and international projects, and other academic activities that enhance the institution's profile and reputation.

→ **Functional Infrastructure and Optimal Learning Conditions**

The institution provides modern and suitable facilities for the teaching process, equipped with technological tools and necessary laboratories for professional practice in media and communication.

→ **Financial Support and Reasonable Tuition Fees**

Institutional policies promote social inclusion by offering affordable tuition to vulnerable groups and providing support to excellent students, thereby fostering equality and access to quality education.

→ **Development Strategy and Well-Defined Procedures**

The program is guided by a clear medium- and long-term development strategy, including consolidated mechanisms for the periodic review of curricula and the implementation of contemporary teaching methods.

→ **Cooperation Agreements and Links with the Labor Market**

The program benefits from cooperation agreements with media outlets, public and private institutions, and partner organizations, supporting students' involvement in professional practice and their orientation towards the job market.

→ **Engagement in Practical and Research Activities**

Students regularly participate in practical activities and research projects through the organization of roundtables, conferences, news analysis, professional internships, and participation in media forums.

→ **Good Interaction with Students and Supportive Institutional Culture**

The department is characterized by a culture of collaboration and open communication with students, encouraging their active involvement in academic and institutional process

Recommendations:

→ **Development of Promotional Strategies to Increase Student Enrollment**

It is recommended that the institution design and implement a comprehensive promotional strategy for the program, based on labor market analysis, trends in media and communication, and consultations with alumni and industry stakeholders. The plan should also include targeting regional markets and attracting students from Albanian-speaking areas outside Albania.

→ **Encouraging Institutional Reflection on Program Sustainability**

It is advisable to develop internal reflective forums with academic staff to address the issue of declining interest and its impact on the academic mission and pedagogical organization. These discussions can contribute to reformulating objectives and enhancing engagement in the program's future development.

→ **Regular Documentation and Publication of Quality Assessment Results**

The institution is strongly advised to develop a well-defined and documented system for the periodic and transparent publication of internal quality assessment results. This process should be integrated with dissemination formats and mechanisms that ensure equal access for all interested parties, including students, academic and administrative staff, and institutional partners.

Specifically, the implementation of Article 8, point d of UT's internal regulations, which requires the publication of unit activities related to quality standards, should be supported by verifiable and accessible evidence. This will strengthen not only institutional transparency but also public trust in the internal quality assurance system.

→ **Expansion of Inter-Institutional and International Cooperation Agreements**

Although the institution maintains a consolidated relationship with the Audiovisual Media Authority (AMA), it is recommended to review and expand the scope of cooperation with other institutional actors, including new media, independent communication agencies, non-profit organizations, and international partners in journalism and communication. The development of joint research projects, academic exchanges, and international student internships will significantly enhance the program's international profile and stimulate improvements in teaching and scientific research.

→ **Improvement in the Management and Documentation of the Academic Achievement Register**

During the evaluation visit, it was noted that the physical register of students' academic achievements was not fully completed by the academic secretary, even though the respective data were stored electronically. Although the use of digital databases for data management is an efficient and modern practice, maintaining the physical register remains a formal and functional requirement by accreditation standards and the regulatory framework for higher education in Albania.

Therefore, it is recommended that the institution take concrete measures to ensure the regular updating and maintenance of the physical academic achievement register, reinforcing the responsibilities of the designated structures and guaranteeing full consistency between the physical and electronic documentation. This measure is essential for meeting legal standards and enhancing the credibility of the academic data management system.

→ **Recommendation for a SWOT Analysis of the Journalism and Communication Bachelor's Program**

During the review of the SWOT analysis presented by the Department of Journalism and Communication, it was observed that some of the elements listed as "weaknesses" do not accurately represent internal weaknesses of the study program, but rather challenges or threats arising from external factors (such as the quality of pre-university education or the mismatch between the labor market and academic preparation).

For this reason, it is recommended that the institution conduct a more accurate SWOT analysis by clearly distinguishing between internal weaknesses (aspects within the program's control) and external threats (challenges arising from the external environment, such as market competition, changes in student profiles, developments in the media sector, or national education policies).

The Higher Education Institution is advised to use internationally accepted standards in preparing SWOT analyses, so that the analysis serves as a genuine tool for internal improvement and strategic planning.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X